



**INSTITUTI I SHËNETIT PUBLIK,
REPUBLIKA E MAQEDONISË**

**UDHËZUES PËR MENAXHIMIN ME
MBETURINAT MJEKËSORE**

UDHËZUES



SHKUP, 2009





Publikues: Instituti i shëndetit publik, Republika e Maqedonisë
50 Divizija nr.6 Shkup, Maqedoni
Udhëzues për menaxhimin e sigurtë me mbeturinat mjekësore

Autorë dhe redaktorë: Doc. Dr. M.Kočubovski, Dr. A. Pollozhani, Dr.sci. V.Kendrovski

Korrigjoi:
Marta Ziba Rashidi

Përgatitja teknike:
Borçe Andonovski
Suzana Dungevska

CIP - Katalogizacija vo publikacija
Nационална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски",
Скопје

628.4.046.02(035)
351.777.61:628.4.046(035)

KOČUBOVSKI, Mihail
Udhëzues për menaxhimin me mbeturinat mjekësore : udhëzues / [autorë
dhe redaktorë M. Koçubovski, A. Pollozhani, V. Kendrovski]. - Shkup : Instituti i
shëndetit publik, Republika e Maqedonisë, 2009. - 103 стр. : илустр. ; 25 см

ISBN 978-9989-716-86-7
1. Položani, Azis [автор] 2. Kendrovski, Vladimir [автор].
1. Koçubovski, Mihail] види Koçubovski, Mihail
а) Медицински отпад - Менаџмент - Прирачници б) Медицински отпад -
санитарен надзор - Прирачници
COBISS.MK-ID 78811402



Doc. Dr. Mihail Koçubovski

Dr. Azis Pollozhani

Dr. sci. Vladimir Kendrovski

PARATHËNIE

„UDHËZUES PËR MENAXHIMIN ME MBETURINAT MJEKËSORE“

Departamenti i Ekologjisë shëndetësore pranë Institutit për shëndet publik në Republikën e Maqedonisë në bazë të përvojës së vet të gjatë duke qënë pjesëtar i ekspertizave ndërkombëtare në këtë lëmi, mori përsipër të ofrojë këtë tekst udhëzues për të kontribuar edhe në këtë formë në një segment shumë të ndijshëm të shëndetit publik.

Teksti është i ndarë në pesë kapituj, si vijon:

- (1) Aspektet ligjore të menaxhimit me mbeturinat mjekësore,
- (2) Rreziku shëndetësor,
- (3) Obligime të personave ligjorë të cilët menaxhojnë mbeturinat,
- (4) Mbikqyrja inspektoriale gjatë menaxhimit me mbeturinat mjekësore,
- (5) Literatura; si dhe tre shtojca që përmbajnë aktet nënligjore me të cilët rregullohen çështjet në këtë lëmi.

Përmbajtja e çdo kapitulli është formuluar qartë, me një gjuhë të lartë profesionale, por të kuptueshme për të gjithë dhe me një stil të përshtatur për personat të cilëve u dedikohet ky udhëzues, para së gjithash menaxherëve dhe personave përgjegjës në të gjithë institucionet shëndetësore, me qëllim që mbeturinat mjekësore të menaxhohen sa më mirë. Janë ofruar njohuritë dhe referencat më të reja si nga vendi ashtu edhe nga bota, për një menaxhim sa më të sigurt me mbeturinat mjekësore, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në të cilët janë të përcaktuara të drejtat dhe obligimet e personave përgjegjës për procesin e menaxhimit me mbeturinat mjekësore. Është përcaktuar edhe një metodologji epidemiologjike-ekologjike e mbështetur edhe me shembuj dhe situata konkrete në shtetin tonë, gjë që këtij materiali i jep një rëndësi të madhe aplikative.

Ky udhëzues do paraqesë një ndihmesë relevante për menaxherët e institucioneve shëndetësore, inspektorateve shtetërorë sanitar dhe shëndetësor, inspektorët për ambientin jetësor, anëtarët e komisioneve për infeksione intraspitalore, specialistët e higjienës etj. dhe do mund të shërbejë si një rikujtim ose edhe për një avancim sa më cilësor të njohurive nga lëmia e menaxhimit me mbeturinat mjekësore, aspektet më të reja të legjislationit relevant nacional dhe atij të Bashkimit Europian, si dhe të udhëzimeve profesionale të Organizatës Botërore të Shëndetësisë për kontrollimin e rreziqeve gjatë menaxhimit me mbeturinat mjekësore, si një funksion qënësor i shëndetit publik.

Udhëzuesi është i shkruar në 103 faqe të formatit B5 dhe përmban një numër të madh të ilustrimeve cilësore – fotografi (9), tabela (6) dhe grafikone (7). Në kapitullin “Literatura” do gjeni referenca për botimet më të reja nacionale si dhe adresa të caktuara në internet.

Mendojmë se ky udhëzues do paraqesë një kontribut të rëndësishëm në angazhimin për sigurimin e literaturës mjekësore posaçërisht nga lëmia e shëndetit publik dhe me këtë edhe standardizimin e procedurave për menaxhimin e sigurt të mbeturinave mjekësore, si një nevojë bazë për një veprimtari shëndetësore të standardizuar dhe cilësore.

Shkup, 2009

Nga autorët



PËRMBAJTJA:

I. ASPEKTET LIGJORE GJATË MENAXHIMIT ME MBETURINAT MJEKËSORE	5
II. RREZIKU SHËNDETËSOR.....	9
II.4.1. Menaxhimi me mbeturinat mjekësore (të rrezikshme dhe jo të rrezikshme)	13
II.4.2. Mbrojtja e shëndetit dhe siguria e punonjësit	26
II.4.2.1. Mjetet mbrojtëse për personat të cilët bëjnë transportin e mbeturinave mjekësore.....	30
III. OBLIGIMET E PERSONAVE JURIDIK TË CILËT MENAXHOJNË ME MBETURINAT.....	31
IV. MBIQYRJA INSPEKTORIALE GJATË MENAXHIMIT ME MBETURINAT MJEKËSORE.....	43
V. LITERATURA.....	54

Shtojca nr. 1 – Rregullore për programin dhe mënyrën e dhënies së provimit profesional për menaxhimin e mbeturinave, formular për vërtetim, si dhe shuma dhe mënyra e pagesës të taksës për dhënie dhe provimit profesional për menaxhimin e mbeturinave.....	57
---	----

Shtojca nr. 2 – Rregullore për formën dhe përmbajtjen e ditarit për evidentimin e manipulimit me mbeturinat, forma dhe përmbajtja e formularëve për identifikimin dhe transportin e mbeturinave dhe forma dhe përmbajtja e formularit për raportet vjetore për manipulimin me mbeturinat.....	65
---	----

Shtojca nr. 3 - Rregullore për mënyrën e manipulimit me mbeturinat mjekësore, si dhe mënyra e paketimit dhe shënimit të mbeturinave mjekësore.....	94
--	----





I. ASPEKTET LIGJORE TË MENAXHIMIT ME MBETURINAT MJEKËSORE

Në nenin 6, pika 19 nga Ligji për menaxhimin me mbeturinat „Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.68/04 dhe 71/04 nga Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për menaxhimin me mbeturinat, Gazeta zyrtare e R: Maqedonisë “nr.107/07 thuhet se – **mbeturina mjekësore** janë mbeturinat që krijohen në institucionet mjekësore dhe shëndetësore (ambulanca, shtëpi shëndeti, spitale, poliklinika, ambulanta stomatologjike, veterinare etj.) të cilat janë rezultat i përdorimit të mjeteve dhe materijalit shëndetësor gjatë diagnostifikimit, shërimit trajtimit dhe parandalimit të sëmundjeve tek njerëzit dhe kafshët.

Sipas sasisë dhe vetive dallohen nga mbeturinat komunale dhe sipas karakteristikave të tyre janë të ngjajshme me mbeturinat e rrezikshme.

Në Nenin 6 të Ligjit për menaxhimin me mbeturinat, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.68/04 dhe 71/04 dhe Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhim me mbeturinat, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.107/07 është shkruar:

- *mbeturina të rrezikshme janë mbeturinat të cilat përmbajnë substanca të cilat kanë një ose më shumë veti të rrezikshme, si për shembull: të jenë eksplozive, reaktive (oksidantët), lehtë të ndizen, irituese, helmuese, **infektive**, kancerogjene, mutagjene, toksike, ekotoksike si dhe në kontakt me ujin, ajrin apo acidet të lirojnë gazra toksike të vërtetuara në pajtim me këtë ligj ose ndonjë dispozitë tjetër, ndërsa njëkohësisht në Listën e llojeve të mbeturinave janë shënuar dhe specifikuar si mbeturina të rrezikshme, përfshirë këtu edhe çdo mbeturinë e cila është e përzier me mbeturina të rrezikshme. (pika 2);*
- *posedues është krijuesi i mbeturinave ose personi juridik dhe fizik i cili ka mbeturina në pronë të tij (pika 25);*
- *prodhues është personi juridik dhe fizik i cili prodhon, importon, eksporton ose distribuon prodhime dhe/ose paketime të cilat në fund të ciklit të tyre jetësor e ngarkojnë ambientin jetësor (pika 26);*
- *manipulimi i mbeturinave nënkupton grumbullimin, selekcionimin, transportin, magazinimin dhe mënjanimin e mbeturinave, përfshirë këtu edhe mbikqyrjen e këtyre aktiviteteve, si dhe masat për mbrojtjen e ambientit jetësor, jetës dhe shëndetit të njerëzve gjatë punës në objekte ose në instalacionet për mënjanimin e mbeturinave dhe kujdesin për to pas mbarimit të punës (pika 27);*





- *menaxhues me mbeturinat është personi i cili është përgjegjës për realizimin e programit për menaxhimin me mbeturinat e personit fizik ose juridik i cili i krijon, përpunon ose mënjanon (pika 30);*
- *trajtimi i mbeturinave nënkupton të gjitha proceset mekanike, fizike, termike, kimike dhe biologjike me të cilat ndryshohen vetitë e mbeturinave, me qëllim që të zvogëlohet vëllimi i tyre ose rrezikshmëria e tyre, që të mund të lehtësohet manipulimi me to ose që të mund të bëhet më i përshtatshëm për përpunim (pika 33);*
- *grumbullimi i mbeturinave nënkupton aktivitete për mbledhjen, klasifikimin dhe/ose përzierjen e mbeturinave për shkak të transportimit të tyre (pika 37);*
- *stacioni ringarkues është vendi ose objekti i magazinimit të përkohshëm, përgatitjes dhe ringarkimit të mbeturinave të destinuara për transport deri në objekte ose instalacione të tjera për magazinim, përpunim, trajtim ose mënjanim (pika 40);*
- *vendi mbledhës është vendi ku ndodhen një ose më shumë enë të cilat shërbejnë për mbledhjen e mbeturinave para se të dorëzohen në qendrën për grumbullim (pika 44).*

Në Nenin 33 të **Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për menaxhimin me mbeturinat, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 107/07** është shkruar:

- mbeturinat e rrezikshme nga objektet në të cilat realizohet mbrojtja shëndetësore e njerëzve përfshijnë **mbeturinat infektive, kimike dhe farmaceutike**, si dhe **barnat citostatike, mjetet e mprehta** dhe lloje të tjera të mbeturinave të rrezikshme;
- programet për menaxhimin me mbeturinat në objektet për mbrojtje shëndetësore dhe veterinarë i miraton Ministri i shëndetësisë, gjegjësisht Ministri i bujqësisë, pyjeve dhe administrimit të ujërave në pajtim me Ministrin e ambientit jetësor dhe planifikimit hapsinor;
- Ministri i ambientit jetësor dhe planifikimit hapsinor në pajtim me Ministrin e shëndetësisë dhe Ministrin e bujqësisë, pyjeve dhe administrimit të ujërave përcakton mënyrat e trajtimit të mbeturinave mjekësore, si dhe mënyrën e paketimit dhe shënimit të mbeturinave mjekësore.

Në bazë të Nenit 73 paragrafi 5 të *Ligjit për menaxhim me mbeturinat, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 68/04, 71/04 dhe 107/07* Ministri i ambientit jetësor dhe planifikimit hapsinor në pajtim me Ministrin e shëndetësisë dhe Ministrin e bujqësisë, pyjeve dhe administrimit të ujërave miraton Rregulloren për mënyrat e trajtimit të mbeturinave mjekësore, si dhe mënyrat e paketimit dhe shënimit të mbeturinave mjekësore (janë sqaruar në vazhdim).





Akte të tjera ligjore dhe nënligjore të cilët, në njëfarë mënyre, e rregullojnë këtë problematikë janë:

- Mbeturinat mjekësore duhet të incinerohen në instalime të disenuara për këtë qëllim si dhe të aprovuara për trajtimin e tyre në pajtim me **EU Directive on Incineration of Hazardous Waste 2000/76/EC**.
- **Basel Convention on the Control of Transboundary Movements of Hazardous Waste and Their Disposal**, ratifikuar në 1997 (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë 49/97).
- **Directive on Hazardous Waste (91/689/EEC)**.
- **Directive on the Landfill of Waste (1999/31/EC)**.
- **Council Decision of 19 December 2002 establishing criteria and procedures for the acceptance of waste at landfills pursuant to Article 16 of and Annex II to Directive 1999/31/EC**.
- **Ligji për ambientin jetësor** (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë 53/05) dhe **Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për ambientin jetësor** (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë 24/07) – janë përcaktuar procedurat, aktivitetet dhe kërkesat e nevojshme që kanë për qëllim mbrojtjen e ambientit jetësor dhe parandalimin e ndotjes me dhënie e lejes së integruar ekologjike A ose B për instalacionet për trajtim dhe përpunim të mbeturinave, përfshirë këtu edhe trajtimin e mbeturinave të rrezikshme si dhe mbeturinave mjekësore.
- **Lista e llojeve të mbeturinave** (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë 100/04) Grupi 18 (mbeturina mjekësore).
- **Ligji për mbrojtje shëndetësore** (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë 17/97, 11/02, 10/04, 84/05, 111/05, 65/06, 05/07).
- **Ligji për shëndetësi publike veterinare** (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë 114/07).
- **Ligji për inspektionin sanitar dhe shëndetësor** (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë 71/06).
- **Ligji për mbrojtjen e natyrës**. Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.67/2004.
- **Rregullore për formën dhe përmbajtjen e ditarit për evidentimin e manipulimit të mbeturinave, formën dhe përmbajtjen e formularëve për identifikimin dhe transportin e mbeturinave si dhe përmbajtjen e formularëve për raportet vjetore për trajtimin e mbeturinave**. Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.07/2006.
- **Rregullore për formën dhe përmbajtjen e kërkesës për marrjen e lejes për përpunim, trajtim dhe/ose për magazinim të mbeturinave, formën dhe përmbajtjen e lejes si dhe kushtet minimale teknike të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë së përpunimit, trajtimit dhe /ose magazinimit të mbeturinave**. Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.23/2007.





- **Programi për mbrojtje shëndetësore preventive në Republikën e Maqedonisë për vitin 2009.** Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.3/2009.
- **Strategjia për menaxhimin me mbeturinat.** Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.39/08.
- **Kushtetuta e vitit 1991 në Nenin 8 thekson mbrojtjen e ambientit jetësor dhe humanizimin e ambienteve dhe natyrës.**





II. RREZIKU PËR SHËNDETIN

Mbeturinat mjekësore paraqesin rrezik për personat të cilët i krijojnë ato, paketojnë, magazinojnë, trajtojnë si dhe për ato që bëjnë dispozimin e tij. Mundësia për infektim me disa sëmundje si psh: SIDA, hepatiti B dhe C, TBC, kolera, difteria etj. është e madhe. Përhapja e këtyre infeksioneve në spitale për shkak të pakujdesisë gjatë manipulimit me këto mbeturina mjekësore duhet të parandalohet duhet të organizohet një menaxhimim i duhur dhe dispozim higjienik i tyre që kjo dukuri të zvogëlohet deri në minimum.

Përveç rrezikut për personat profesionistë të cilët punojnë në institucionet shëndetësore/veterinare, rreziku për shëndetin është prezent edhe për personat të cilët punojnë në ndërmarrjet publike komunale dhe/ose personat fizik/juridik të cilët janë të licencuar për mënjanimin e mbeturinave të rrezikshme (mbeturinat mjekësore).

Rreziku për përcjelljen e sëmundjeve infektive ekziston edhe tek personat të cilët bëjnë riciklimin sekundar të mbeturinave në kontejnerë dhe deponi.

Organizata botërore e shëndetit në vitin 2007 realizoi një vlerësim të rrezikut shëndetësor që vjen nga manipulimi jo i drejtë i mbeturinave mjekësore në botë:

- 8-16 milionë hepatit B;
- 2,3-4,7 milionë hepatit C;
- 80.000-160.000 infeksione HIV.
- Mendohet se, në mbarë botën gjatë një viti paraqiten këto raste të infeksioneve për shkak të ripërdorimit të gjilpërave të shiringave pa sterilizim paraprak. Shumë nga këto infeksione do mund të evitoheshin nëse shiringat do të deponoheshin në mënyrë të sigurtë. Kjo dukuri është prezente sidomos në disa vende të Afrikës, Azisë dhe Europës Qendrore dhe Lindore (OBSH, 2007).

Në Tabelën 1 janë paraqitur infeksionet që janë si rezultat i lëndimeve gjatë punës tek punonjësit shëndetësor në institucionet shëndetësore në SHBA.

Tabela 1. Infeksione që janë si rezultat i lëndimeve me mjete të mprehta gjatë punës tek punonjësit shëndetësor në SHBA. (PAHO*/WHO)

Kategoria profesionale	Numri i të lënduarve në vit	Numri i VHB infeksioneve nga lëndimet me mjete të mprehta
Infermiere në spitale	17700-22200	56-96
Infermiere në institucione shëndetësore private	28000-48000	26-45






Laborantë	800-7500	25
Pastrues	11700-45300	23-91
Ndihmës mjek/Teknik	12200	24
Mjekë dhe stomatologë në spital	100-400	<1
Mjekë në institucione shëndetësore private	500-1700	1-3
Stomatologë në institucione shëndetësore private	100-300	<1
Teknikë dhëmbësh në institucione shëndetësore private	2600-3900	5-8
Personeli për ndihmë të shpejtë mjekësore (në teren)	12000	24
Punonjës komunalë (jashtë spitalit)	500-7300	1-15

* PAHO (Organizata Shëndetësore Pan-Amerikane/Pan-American Health Organization)

Mënyra dhe rrugët e shpërndarjes së shkaktarëve të sëmundjeve ngjitëse në procesin e menaxhimit të mbeturinave mjekësore është paraqitur në Grafikon 1.



Grafiku 1. Mënyra dhe rrugët e shpërndarjes së shkaktarëve të sëmundjeve ngjitëse në procesin e menaxhimit të mbeturinave mjekësore



Mbeturinat mjekësore sipas konsistencës mund të jenë mbeturina të ngurta dhe të lëngëta ndërsa sipas përmbajtjes së materjeve të dëmshme dhe të rrezikshme ato mund të jenë:

a) Mbeturina të rrezikshme:

- **Infektive:** gjaku dhe produktet e tij, mbeturinat e izoluar nga pacientët me aftësi të larta infektive (ushqimi, çarçafët), vaksinat etj;
- **Mbeturina anatomike:** indet, organet, biopsitë, autopsitë, ekskretë, organe dhe inde të infektuara nga patogjenët e njeriut;
- **Mbetjet nga mjete e mprehta:** gjilpërat, skalpelët, infuzionet etj.;
- **Mbeturinat kimike:** tretjet, reagjensët, zhvilluesit e filmave, etj. të cilat mund të jenë toksike, korozive, ndezëse, eksplozive dhe kancerogjene;
- **Mbeturina farmaceutike:** medikamentet e ndryshme, mbeturinat nga kimioterapia, që mund të jenë citotoksike, mutagjene, kancerogjene etj;






- **Mbeturina radioaktive:** çdo material i lëngët, ose patologjik i kontaminuar me izotope radioaktive;
- **Enët me presion:** çdo enë që përmban gazra që gjatë performimit të paqëllimshëm ose incineracionit mund të eksplodojnë.

b) Të parrezikshme. Janë të ngjajshme me mbeturinat komunale, çdo mbeturinë e ngurtë si letër ose material për paketim, që nuk i ka karakteristikat e materialit të rrezikshëm të përmendura më lartë.

Sipas pjesëmarrjes në mbeturinat mjekësore, mbeturinat infektive përbëjnë pjesën më të madhe të tyre (76%) dhe me to duhet të manipulohet në një mënyrë të veçantë (Grafiku 2). Mbeturinat patologjike, meturinat kimike, barnat citostatike dhe citostatikët, si dhe mbeturinat radioaktive i nënshtrohen mënyrave të veçanta të menaxhimit deri në dispozimin final të tyre.

Grafiku 2. Përbërja e mbeturinave mjekësore sipas OBSH




Vlerësimi se vallë mbeturinat të cilat krijohen në vendin e punës janë të rrezikshme apo jo është përshkruar më detajisht në Grafikon 3.





Grafiku 3. Vlerësimi i mbeturinave të rrezikshme



II.4.1. Menaxhimi me mbeturinat mjekësore (të rrezikshme dhe jo të rrezikshme)

Minimizimi – është metoda e parë më efikase dhe më ekonomike për reduktimin e kuantitetit të mbeturinave mjekësore, me çrast zvogëlohet dhe veprimi ndaj ambientit jetësor në të gjitha mediumet e tij dhe atë me reduktimin e aerondotjes, ndotjes së tokës, ujit si dhe rritjen e kapacitetit të deponisë. Kjo mënyrë, në vend të asgjësimit të disa materialeve dhe gjësendeve të përdorura, mundëson shfytëzimin e sërishëm ose riciklimin e tyre.

Menaxhimi me mbeturinat mjekësore duhet të organizohet sipas këtyre etapave të rekomanduara:


1. **Ndarja** - mundësisht të praktikohet para fillimit të aktiviteteve që krijojnë mbeturina mjekësore si dhe mbeturina potenciale infektive, si një element kyç për zvogëlimin e mbeturinave mjekësore.





2. **Identifikimi** – duhet të bëhet me sistem minimal të koduar, që të mund të ndahen dhe të identifikohen mbeturinat mjekësore të rrezikshme. Me ngjyrë të verdhë (në Republikën e Maqedonisë), disenjohen thasët dhe kontejnerët për mbeturinat mjekësore të rrezikshme ndërsa me ngjyrë të zezë kontejnerët me mbeturina (komunale) jo të rrezikshme. Vendimin për sitemin e koduar me ngjyra e sjell Ministria e Shëndetësisë. Thasët me mbeturina infektive dhe kontejnerët për gjilpëra janë të shënuara edhe me simbolet për biohazard ndërkombëtar. (foto 1). Është e nevojshme që të sigurohet lokacioni i përshtatshëm i kontejnerëve me përforsim paraprak dhe ilustrim të procedurave ndarëse. Është e nevojshme të përpilohet lista e mbeturinave të rrezikshme dhe materjaleve që në kushte të caktuara mund të klasifikohen si të rrezikshme. Për llojet e tjera të mbeturinave mjekësore ngjyra e ambalazhit është e përcaktuar me Rregulloren për mënyrat e manipulimit me mbeturinat mjekësore, si dhe mënyrën e paketimit dhe shënimit të mbeturinave mjekësore.

Foto 1. Kontejnerë mbeturina infektive dhe shenjë për biohazard





3. **Manipulimi** – ka si kusht një evidencë të plotë të vendit në të cilin krijohen mbeturinat, transportit, trajtimit dhe deponimit.
- Pas mbledhjes dhe grumbullimit të mbeturinave mjekësore, ato duhet të identifikohen sipas llojit, vendit në të cilin janë krijuar dhe objekti nga i cili rrjedhin;
 - Në çdo njësi mjekësore lokale (ambulante, poliklinikë, spital, laborator) duhet saktë të përcaktohet një **pikë (punkt) lokale mbledhëse (hapësirë)** për ambalazhin e mbushur me mbeturina. Transferin e mbeturinave nga vendet e punës, gjegjësisht nga ambientet punuese deri tek pika mbledhëse lokale e kryen personeli ndihmës (transfer i brendshëm lokal). Te pika mbledhëse kanë qasje vetëm persona të autorizuar (Foto 2).

Foto 2. Pika mbledhëse lokale



- Transferin e mbeturinave nga pika mbledhëse lokale e njësive mjekësore ose reparteve spitalore deri te pika mbledhëse qendrore e të gjithë institucionit (që duhet të jetë e rrethuar, me ventilim të përshtatshëm dhe në të mos kenë qasje persona të paautorizuar, qen, mace dhe kafshë të tjera) e bën personeli ndihmës (transfer deri te pika qendrore mbledhëse). Në pikën qendrore mbledhëse kanë qasje vetëm persona të autorizuar të cilët kanë për detyrë të komunikojnë me shërbimet për marrjen dhe transportin e mbeturinave (Foto 3). Nëse ka mundësi teknike, mund të bëhet larja e kontejnerëve dhe pikës mbledhëse. Gjithashtu, sipas nevojës, duhet të bëhet edhe dezinfektimi i kontejnerëve në intervale të caktuara kohore,





si dhe me kërkesë të Inspektoratit shtetëror sanitar dhe shëndetësor. Transporti nga pikat mbledhëse lokale deri te **pika mbledhëse qendrore** duhet të kryhet përmes një rruge të përcaktuar dhe në orar të caktuar (me qëllim që të zvogëlohet rreziku nga kontaminimi gjatë kontaktit me punonjësit shëndetësor, pacientët, etj.).

Foto 3. Pika qendrore mbledhëse për mbeturinat mjekësore



Në politikën për mbledhjen e mbeturinave mjekësore duhet të bëjë pjesë:

- lista e personelit përgjegjës për mbledhjen;
- itinerari i mbledhjes;
- rruga e transportit të mbrendshëm;
- matja e peshës së mbeturinave, ose numërimi i copave të ambalazhit të mbushura me mbeturina të rrezikshme, me etiketa në të cilat është shkruar vendi nga ku burojnë;
- mënyra e mbylljes (paketimit) të ambalazhit në të cilin ka mbeturina të rrezikshme;
- përdorimi i mjeteve mbrojtëse personale;
- dekontaminimi dhe procedura e mirëmbajtjes së higjienës së deposë;
- dhe shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e sigurisë së deposë.

Në këtë politikë duhet të bëjë pjesë edhe kufizimi i kohëzgjatjes së magazinimit:

- mbeturinat e pangrira nuk duhet të ruhen më shumë se 3 ditë (72 orë);
- mbeturinat e ngrira nuk duhet të ruhen më shumë se 5 ditë (temperatura është një faktor i rëndësishëm për shtimin e bakterieve).





Mbeturinat infektive duhet të jenë të paketuara me qëllim që punonjësit dhe popullata të jenë të mbrojtur nga sëmundjet të cilat janë si rezultat i këtij lloj mbeturinash.

Me mënyrën e re të menaxhimit me mbeturinat mjekësore është planifikuar të lëshohet në përdorim incineratori i ri për djegjen e mbeturinave të rrezikshme në Deponinë Sanitare "Drislla", do të implementohet sistemi i ri i transportimit të mbeturinave mjekësore – mbledhjen e tyre nga të gjitha institucionet shëndetësore dhe ruajtjen e tyre në dhoma ftohëse (si stacione ringarkuese për mbeturinat në pajtim me Nenin 37 të Ligjit për menaxhim me mbeturinat, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.68/04) dhe transportin me automjete speciale të kompanive të licencuara për transport të mbeturinave të rrezikshme (Foto 4).

Foto 4. Dhoma ftohëse për mbeturina mjekësore



4. **Trajtimi** – është përpunimi i mbeturinave infektive me ndihmën e ndonjë metode, teknike apo procesi që do duhet të ndryshojë karakterin biologjik të mbeturinave. Rekomandohet që para deponimit përfundimtar të tyre të përpunohen të gjitha mbeturinat. Teknologjitë që përdoren për trajtimin e mbeturinave infektive janë:

1. *incineracioni;*
2. *dezinfektim me autoklavim me avull (Foto 5);*
3. *dezinfektimi me mikrovalë;*
4. *dezinfektimi mekanik/kimik.*





Foto 5. Autoklavi



Si metodë për shkatërrimin e mbeturinave gjatë kohë është përdorur metoda e djegies. Por, përsëri nuk ekziston një teknologji ideale për trajtimin e mbeturinave mjekësore. Ekziston incinerator me temperaturë të lartë për djegien e mbeturinave infektive të ngurta të marra nga institucionet shëndetësore në Shkup, Tetovë dhe Kumanovë, që ndodhet në deponinë sanitare "Drislla". Transporti i mbeturinave infektive duhet të bëhet me automjet të veçantë i cili do shërbejë vetëm për atë qëllim (Foto 6).

Foto 6. Automjet për transportin e mbeturinave mjekësore



Në tabelë 2 janë paraqitur përvoja nga përdorimi i metodave të ndryshme të trajtimit dhe dispozimit të mbeturinave mjekësore. Në Republikën e Maqedonisë gjatë menaxhimit të mbeturinave mjekësore deri më tani janë aplikuar të gjitha metodat, përveç trajtimit në furrë me mikrovalë i cili është mjaft i kushtueshëm dhe nuk mundëson reduktimin e mbeturinave mjekësore.

Tabela 2. Përvoja nga metodat e ndryshme të trajtimit dhe mënjanimet të mbeturinave mjekësore

	Diegie e hapur	Deponitë e komunës	Incineracion i vendit	Incineracion në temperaturë të lartë	Autoklavim	Furra me mikro valë	Sterilizim kimik	Deponia sanitare
Organizma infektiv	Keq	Nuk ka	Keq deri mesatare	Shumë mirë	Mirë	Mirë	Mirë	Mirë
Pjesë të trupit, gjak etj.	Mirë	Nuk ka	Mirë	Shumë mirë	Keq deri mesatare	Keq deri mesatare	Keq deri mesatare	Mirë
Barna	Mirë	Nuk ka	Mirë	Shumë mirë	Nuk ka	Nuk ka	Keq deri mesatare	Mesatare deri mirë
Objekte të mprehta	Mesatare	Nuk ka	Mesatare	Shumë mirë	Keq deri mesatare	Keq deri mesatare	Mesatare	Mesatare
Transformimi i mbeturinave	Mesatare	Nuk ka	Mirë	Shumë mirë	Mesatare	Mesatare	Mesatare	Mirë
Parandalimi i qasjes së njeriut	Mesatare	Shumë keq	Mirë	Shumë mirë	Shumë mirë	Shumë mirë	Shumë mirë	Mesatare deri mirë

Në tabelën 3 janë paraqitur mënyrat e paketimit të mbeturinave mjekësore varësisht nga metoda e trajtimit





Tabela 3. Mënyrat e paketimit të mbeturinave mjekësore varësisht nga metoda e trajtimit

Kategoria e mbeturinave të rrezikshme	Deponia	Incineracioni	Autoklavimi	Furra me mikrovalë	Dezinfektimi kimik
Gjilpëra	Kontejnerë të mbyllur të verdhë	Kontejnerë të verdhë	Kontejnerë me vrima	Kontejnerë me vrima	Kontejnerë me vrima
Mbeturina patologjike	Thasë të padepërtueshëm, (të kuq) dhe varrosen në vend të veçantë në varreza	Tek ne nuk është e lejuar për shkak të normave etike dhe fetare	Nuk është e mundur	Nuk është e mundur	Nuk është e mundur
Mbeturina të tjera potenciale të rrezikshme	Thasë me ngjyrë / kontejnerë (të verdhë)	Thasë me ngjyrë (të verdhë)	Thasë me ngjyrë (të verdhë)	Thasë me ngjyrë (të verdhë)	Thasë me ngjyrë (të verdhë)
Kimikalie të rrezikshme	Kontejnerë (të lëngëta) thasë (të ngurta) dhe në deponi për mbeturina të rrezikshme	Kontejnerë (të lëngëta) thasë (të ngurta)	Nuk është e mundur	Nuk është e mundur	Nuk është e mundur
Mbeturina farmaceutike	Thasë/kontejnerë me ngjyrë -të gjelbër	Thasë/kontejnerë me ngjyrë -të gjelbër	Nuk është e mundur	Nuk është e mundur	Nuk është e mundur

5. **Dispozimi** - i mbetjes (hirit) të mbeturinave mjekësore të trajtuara mund të bëhet me deponim në mënyrë të sigurtë në sektor të veçantë ose pjesë të deponisë sanitare, e disenjuar për këtë qëllim. Metodatat më të mira për dispozimin e mbetjes përfundimtare pas trajtimit të mbeturinave mjekësore janë paraqitur në tabelën 4.

Tabela 4. Metodatat për dispozimin e mbetjes përfundimtare pas trajtimit të mbeturinave mjekësore

Hi nga incineratori dhe materje të tjera të ngurta	Deponia sanitare (nëse testet vërtetojnë se nuk paraqet rrezik, në pajtim me rregulloren për ekologji mjekësore. Në të kundërtën, duhet të deponohet në deponi për mbeturina të rrezikshme).
Mbeturina të lëngëta	Kanalizimi (vetëm nëse shpërbëhen, neutralizohen ose eventualisht dezinfektohen, e kjo gjë pranohet nga qeveritë lokale)
Mbeturina anatomike	Groposje (në pjesë të veçantë të varrezave me një procedurë të veçantë)



Është vlerësuar se në Republikën e Maqedonisë krijohen nga 8 dhe 10.000 Tonelata/në vit mbeturina nga institucionet shëndetësore (mbeturina komunale dhe mjekësore).

Në Tabelën 5 janë paraqitur rezultatet nga hulumtimi i realizuar, përmes evidentimit të mbeturinave të ngurta dhe të lëngëta mjekësore dhe jomjekësore, në institucionet shëndetësore të sektorit publik në territorin e qytetit të Shkupit në periudhën 1995/96 (Filjanski dhe bashkëpunëtorë, 1996).

Tabela 5. Rezultate nga hulumtimi i kryer në mbeturina dhe jombeturina mjekësore në ngurta dhe të lëngëta në qytetin e Shkupit në periudhën kohore 1995/96

Lloje të institucioneve	Nr. i institucioneve	Sipërfaqja e përgjithshme e shfrytëzuar / m ²	Mbeturina të forta në tonelata		Mbeturina të lëngëta në litra	
			gjithsejt	mjekësore	gjithsejt	mjekësore
stacionarë (nr. i shtretërve)	29 (4.775)	189.236	2.350	231 9,8%	211.7 86	82.37 9 38,9%
ambulant. - poliklin. (nr. i të siguruar.)	23 (459.129)	43.959	243	109 45%	27.38 1	17.32 0 63%
shkenc.-arsim. dhe shëndetësoro-publik	17	27.841	106	54 51,1%	37.94 0	19,53 0 51,5%
Gjithsejt	69	261.036	2.699	394 14,6%	277.1 07	119.2 99 43%

Nga tabela mund të shihet se në sasinë e përgjithshme e mbeturinave të forta në 2.699 tonelata, mbeturinat mjekësore bëjnë pjesë me 14.6%, ndërsa në sasinë e përgjithshme të mbeturinave të lëngëta në 277.107 litra mbeturina të lëngëta, 43% janë mbeturina mjekësore.

Sasia e mbeturinave infektive të ngurta të cilat prodhohen gjatë një viti në spitale dhe në institucione të tjera në nivel të Republikës së Maqedonisë mendohet se arrin shifrat rreth 1000 tonelata, nga të cilat vetëm në qytetin e Shkupit rreth 380 tonelata janë mbeturina mjekësore të rrezikshme të ngurta. (Koçubovski, 2005). Kjo gjë është vërtetuar edhe në Planin Nacional për menaxhimin me mbeturinat në Republikën e Maqedonisë në vitin 2005 (Tabela 6).





Tabela 6. Vlerësim i mbeturinave mjekësore infektive të ngurta të prodhuara në Republikën e Maqedonisë

	Numri i shtretërve*	tonelata/vit	Numri i mjekëve**	tonelata/vit	Punonjës në mbrojtjen shëndetësore**	tonelata/vit
Republika e Maqedonisë	9699	996	4573	927	6533	934
Shkup	3896	400	1974	400	2797	400

* ISHP Enti republikan për mbrojtje shëndetësore-Shkup

** Enti shtetëror për statistikë

Pjesë nga Plani Nacional për Menaxhimin me Mbeturinat, 2005

Në pajtim me PNAESH (Planin Nacional Akcionar Ekologjiko Shëndetësor) të miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë në 31.05.1999, një nga projektet prioritarë për implementim ishte ai për djegjen e mbeturinave infektive të ngurta nga Institucionet shëndetësore në Republikën e Maqedonisë me një incinerator me temperaturë të lartë.

Në pajtim me mundin e dhënë dhe udhëheqjen profesionale të masave sanitaro higjienike dhe kundërepidemiologjike nga ana e Entit republikan për mbrojtje shëndetësore – Shkup, me ndihmën e Organizatës botërore të shëndetësisë- Përfaqësia për ndihmë humanitare-Shkup, me donacion të DFID –të Britanisë së Madhe për Ministrinë e shëndetësisë në Republikën e Maqedonisë, u siguroa incineratori (furrë me temperaturë të lartë për djegjen e mbeturinave të ngurta mjekësore e cila i plotëson standardet e emisionit BS 3316-të cilat asokohe vlenin për Britaninë e Madhe.). Marrëveshja është nënshkruar nga DFID –e Britanisë së Madhe, Ministria e shëndetësisë në Republikën e Maqedonisë dhe OBSH- Përfaqësia për ndihmë humanitare-Shkup në 20.09.1999. Incineratori ndodhet në Deponinë sanitare “Drisla”. (Foto 7)



Foto 7. Incineratori për mbeturina mjekësore në Deponinë sanitare “Drislla”.



Për menaxhimin e sigurt me mbeturinat e ngurta infektive dhe potenciale infektive nga Institucionet shëndetësore në Republikën e Maqedonisë është përpiluar një Udhëzues për menaxhimin e sigurt me mbeturinat mjekësore nr. 09-51 nga 13.01.2000 nga ISHP Enti republikan për mbrojtje shëndetësore (Kendrovski dhe bashkëpunëtorë, 2000), i cili është distribuar në të gjitha institucionet shëndetësore në Shkup e pastaj edhe në mbarë Republikën e Maqedonisë. Është përpiluar edhe një vlerësim profesional për menaxhimin e sigurt me mbeturinat e ngurta infektive nga ana e Entit republikan për mbrojtje shëndetësore nr. 09-177 në 26.01.2000 dhe i njëjti është dorëzuar në Ministrinë e shëndetësisë dhe Inspektoratin republikan sanitar dhe shëndetësor. Është realizuar trajnimi profesional nga ana e ISHP Entit republikan për mbrojtje shëndetësore i të gjithë personave përgjegjës nga institucionet shëndetësore publike në vend dhe atë në vitin 2000 dhe 2002, si dhe i përfaqësuesve të Inspektoratit republikan sanitar dhe shëndetësor pranë Ministrisë së shëndetësisë, si dhe i inspektorëve nga Inspektorati shtetëror për mbrojtjen e ambientit jetësor dhe Inspektoratit komunal (Foto 8)



Foto 8. Trajnimi për menaxhim të sigurt me mbeturinat mjekësore.



Në pajtim me PNAESH (Planin Nacional Akcionar ekologjiko-shëndetësor) të miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë për vitin 2001, 2002, 2003 dhe 2004 siguroi mjete financiare për mbulimin mujor të shpenzimeve për mbledhjen e sigurtë, transportin, djegien dhe deponimin e mbeturinave infektive të ngurta nga institucionet shëndetësore në Shkup. Këto shpenzime arrinin shifrat prej 6.000.000 denarë/në vit.


Në programin për mbrojtje shëndetësore preventive në Republikën e Maqedonisë për vitin 2005, nga Buxheti janë miratuar mjete financiare për mbulimin e shpenzimeve me vlerë prej 3.000.000 denarë për 6 muaj (përfundimisht deri në muajin qershor).

Për realizimin e mëtejshëm të një menaxhimi sa më të sigurtë të mbeturinave mjekësore të ngurta nga institucionet shëndetësore në mbarë territorin e Republikës së Maqedonisë praktikohet pagesë sipas sasisë (denar për kilogram) për mbeturina mjekësore të selektuar, mbledhur dhe të deponuar në mënyrë të sigurtë nga vetë institucionet shëndetësore, si publike ashtu edhe private, me ç'rast duhet të nënshkruhen kontrata me personat juridik dhe fizik të Nenit 20, paragrafi 1 nga Ligji për menaxhim me mbeturinat, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.68/2004.

Për zgjidhjen e plotë të problemit për menaxhim të sigurtë të mbeturinave të ngurta dhe ato potenciale infektive të institucioneve shëndetësore në Republikën e Maqedonisë është e nevojshme të kompletohet incineratori i deponisë sanitare i cili është nën kompetencë të Ministrisë të ambientit jetësor. Një mundësi tjetër është transporti i të gjithë mbeturinave infektive nga të gjithë institucionet shëndetësore në mbarë vendin me mjete transporti të veçanta dhe djegia e tyre në një incinerator me temperaturë të lartë (me filtër për eliminimin e gazrave të dëmshëm) i cili do i plotësojë të gjitha normat emituese sipas direktivave të BE.

Institucionet kompetente për menaxhimin e sigurtë të mbeturinave mjekësore në Republikën e Maqedonisë janë paraqitur në Grafikon 4.

Grafiku 4. Menaxhimi i mbeturinave në Republikën e Maqedonisë



Në vitet 2007-2008 Qendra rajonale për mbrojtjen e ambientit jetësor, Përfaqësia në Maqedoni realizoi projektin "Trajnime për manipulim me mbeturinat mjekësore".

Projekti kishte për qëllim t'i avancojë praktikat e manipulimit me mbeturinat mjekësore në spitale dhe institucione të tjera shëndetësore. Përfitues përfundimtar ishin Ministria e ambientit jetësor dhe planifikimit hapsinor dhe Ministria e shëndetësisë, ndërsa mjetet financiare u siguruan nga programi DEFRA Ambasadës Britanike në Shkup.





II.4.2. Mbrojtja e shëndetit dhe siguria e punonjësit

Politika e menaxhimit me mbeturinat mjekësore duhet të përfshijë edhe një mbikqyrje të vazhdueshme të mbrojtjes së shëndetit të punonjësve dhe sigurinë e tyre, me qëllim që të sigurohet një manipulim i pandërprerë, trajtim, ruajtje dhe dispozim i mbeturinave mjekësore, si dhe implementim i tyre (gjegjësisht një trajnim i realizuar me sukses), që do të thotë se masat preventive të ndërmarra funksionojnë mirë. (Ligji për inspektionin sanitar dhe shëndetësor, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.37/06).

Masat e drejta shëndetësore dhe të sigurisë përfshijnë:

- trajnim adekuat;
- përdorimin e mjeteve mbrojtëse personale (dorashka mbrojtëse, maska mbrojtëse, etj);
- përcaktim i një programi efektiv për mbrojtje shëndetësore të punonjësit i cili do përfshijë edhe imunizim (për mbrojtje nga Hepatiti B në vitin 2005 është filluar vaksinimi i punonjësve shëndetësor në rrezik), profilakse post ekspozuese dhe mbikqyrje mjekësore.

Për mbrojtjen e shëndetit të punonjësve shëndetësor në Health and Safety Framework Directive 89/391/EEC është shkruar si në vijim:

- Ka të bëjë me mbrojtjen e punonjësve të cilët gjatë punës të tyre ekspozohen ndaj agjensëve biologjik dhe deri më tani është plotësuar disa herë me akte të reja.
- Përputhshmëri me kërkesat minimale të parapara për një standard më të mirë të mbrojtjes dhe shëndetit, si dhe mbrojtje të punonjësve nga rreziqet që kanë të bëjnë me ekspozimin ndaj agjensëve biologjik, si obligim kryesor.
- Masa për përmirësimin e mbrojtjes dhe shëndetit të të punonjësve gjatë punës. Obligimet që rrjedhin nga kjo direktivë duhet të aplikohen plotësisht tek punonjësit të cilët ekspozohen ndaj agjensëve biologjik.
- Një njohje më e madhe dhe më e saktë e rreziqeve nga ekspozimi ndaj agjensëve biologjik mund të arrihet përmes dokumentimit të proceseve dhe analizave të rasteve të ndryshme.
- Listat dhe klasifikimet e agjensëve biologjik duhet të kontrollohen dhe ndryshohen vazhdimisht duke u bazuar në hulumtimet e reja shkencore.
- Punëdhënësit janë të obliguar të sigurojnë kushte të nevojshme me qëllim që të përmirësojnë mbrojtjen e punonjësve, si dhe të të ndërmarrin masa parandaluese për mbrojtjen e punonjësve të cilët ekspozohen ndaj agjensëve biologjik.

Në Ligjin për mbrojtjen e popullatës nga sëmundjet ngjitëse, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.66/04 në Nenin 49 është shkruar:





- Monitorimi i infeksioneve intraspitalore dhe marrja e masave për ndalimin e paraqitjes dhe eliminimin e tyre është obligim i çdo institucioni shëndetësor.
- Drejtori i institucionit shëndetësor është përgjegjës për ndalimin dhe eliminimin e infeksioneve intraspitalore.
- Drejtori ka për detyrë të formojë komision për monitorimin e infeksioneve intraspitalore dhe të përcaktojë program për ndalimin dhe eliminimin e infeksioneve intraspitalore.
- Programi nga paragrafi 3 i këtij Neni përmban:
 - 3) realizim doktrinar të sterilizimit, dezinfektimit, pastrimit si dhe manipulim të sigurtë me mbeturina mjekësore dhe mbeturina të tjera;

Neni 61

- Paragrafi 2 – Mbikqyrjen inspektoriale gjatë zbatimit të këtij ligji dhe rregullave të sjella në bazë të këtij ligji e realizon Inspektorati shtetëror sanitar dhe shëndetësor.

Në Ligjin për siguri dhe shëndet gjatë punës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.92/07) vërtetohen masat për siguri dhe shëndet gjatë punës, obligimet e punëdhënësit dhe të drejtat dhe obligimet e punonjësve nga lëmia e sigurisë dhe shëndetit gjatë punës, si dhe masat parandaluese kundër rreziqeve profesionale, eliminimin e faktorëve të rrezikut për aksidente, informimi, konsultimi, trajnimi i punonjësve dhe përfaqësuesëve të tyre dhe pjesëmarrja e tyre në planifikimin dhe ndërmarrjen e masave për siguri dhe shëndet gjatë punës.

Sipas Nenit 41 punonjësit duhet të respektojnë masat e përcaktuara për siguri dhe shëndet dhe të përdorin pajisjet e caktuara për mbrojtje personale dhe pas përdorimit t'i kthejnë në vendin e tyre, si dhe të bëjnë kontrolla shëndetësore në pajtim me këtë ligj dhe me dispozita të tjera nga kjo lëmi.

Në Nenin 59 është shkruar se me gjobë në vlerë prej 50 euro (dënim mandatar në vend) me vlerë në denarë do të dënohet punonjësi nëse nuk i respekton masat e përcaktuara të sigurisë gjatë punës dhe nëse nuk përdor pajisjet për mbrojtje personale nga Neni 41 paragrafi 2.

Dispozitat e këtij ligji zbatohen në të gjitha veprimtaritë e sektorit privat dhe atij publik, për të gjithë personat e siguruar nga lëndimet në vendin e punës ose sëmundjet profesionale sipas rregullave për sigurim penzional, invalidor dhe shëndetësor si dhe për të gjithë personat e tjerë të cilët marrin pjesë në proceset punuese.

Mbikqyrjen e zbatimit të dispozitave të këtij ligji e realizon Ministria e punës dhe politikës sociale, ndërsa mbikqyrjen inspektoriale nga lëmia e sigurisë dhe shëndetit gjatë punës e realizon





Inspektorati shtetëror i punës sipas këtij ligji dhe sipas Ligjit për inspektimin e punës.

Vështirësi më të shpeshta që kanë të bëjnë me mbeturinat mjekësore janë:

- Mungesa e menaxhimit me mbeturinat;
- Mungesa e vëdijsshmërisë për hazardët shëndetësor;
- Financimi dhe burimet njerëzore të pamjaftueshme;
- Kontroll i dobët i dispozimit të mbeturinave.

Hapa të cilat do çojnë drejt përmirësimit:

- Ndërtimi i një sistemi gjithpërfshirës, adresim i drejtë i përgjegjësive, shpërndarje e burimeve, manipulim dhe dispozim i drejtë.
- Ky është një proces afatgjatë, i mirëmbajtur me një përmirësim të vazhdueshëm;
- Ngritje e vetëdijes dhe trajnim për rreziqet lidhur me mbeturinat mjekësore dhe një praktikë të sigurtë;
- Përzgjedhje e opsioneve të sigurta dhe ekologjike për menaxhim, për mbrojtje të njerëzve nga hazardët gjatë mbledhjes, manipulimit, ruajtjes, transportit, trajtimit ose dispozimit të mbeturinave mjekësore.

OBSH planifikon të publikojë një sërë udhëzimesh dhe mjtesh praktike, ndërsa deri më tani ka publikuar një numër të madh udhëzuesish për menaxhim të sigurtë me mbeturinat mjekësore:

- Publikim i udhëzuesit për personat përgjegjës për menaxhimin me mbeturinat mjekësore në qendrat për mbrojtje shëndetësore primare;
- Implementim i sistemeve për mbeturinat mjekësore në nivel nacional;
- Zhvillimi i një databaze për zgjidhje praktike për menaxhimin me mbeturinat mjekësore, kryesisht të destinuar për vendet në zhvillim;
- Testimin e zgjidhjeve me kosto të ulët për menaxhimin me mbeturinat mjekësore;
- Përgatitje të një udhëzuesi për dispozimin e gjakut dhe qeseve me gjak;
- Qasje për promovimin e përdorimit të produkteve në aktivitetet për realizimin e mbrojtjes shëndetësore të cilët do ndikojnë në zvogëlimin e krijimit të mbeturinave ose në krijimin e mbeturinave më pak të rrezikshme.
- **Safe Management of Wastes from Health-Care Activities. WHO, Geneva; 1999** (korniza regullatore, planifikim, minimizim i mbeturinave dhe riciklim, manipulim, ruajtje dhe transport, trajtim, dispozim dhe trajnim).
- **Teacher's Guide, Management of Wastes from health-care activities. WHO, Geneva; 1998.**





- **Guidelines for the Safe Disposal of Unwanted Pharmaceuticals in and after Emergencies. WHO, Geneva; 1999.**
- **Starting Health Care Waste Management in Medical Institutions a Practical Approach. WHO, Copenhagen; 2000.**

OBSH në Shëndet për të gjithë në shekullin 21 në qëllimin 10, Ambient jetësor i shëndetshëm dhe i sigurtë planifikon që deri në vitin 2015, njerëzit e rajonit të jetojnë në një ambient jetësor më të sigurt, me një ekspozim ndaj materjeve ndotëse të rrezikshme për shëndetin e njeriut niveli i të cilit nuk do tejkalojë standardet e caktuara ndërkombëtare.

Fakte për disa infeksione virale:

- Me përhapjen e Ebolas në vitin 1995 në Kikvit, Kongo, 90 nga 296 raste kanë qënë punonjës shëndetësor, me një nivel mortaliteti prej 79%.
- Gjatë përhapjes së etheve hemoragjike Kongo-Krime në Pakistan, 10 nga 17 punonjësit shëndetësor të ekspozuar janë infektuar, dhe ka pasur 2 raste të vdekjeve.
- VHB gjatë 1 viti, shkaktojnë vdekjen e 2 milionë njerëzve në botë.
- Sot, në mbarë botën jetojnë rreth 500 milion bartës.
- VHB janë në vendin e nëntë në botë për nga numri i vdekjeve.
- VHB mund të shkaktojë cirozë dhe kancer në mëlçi.
- Në të shumtën e rasteve përçohet përmes shkëmbimit të gjakut ose përmes marrëdhënieve seksuale.

OBSH vlerëson se me injektimin me gjilpëra të infektuara shkaktohen:

- 21 milion infeksione VHB (32% nga të gjitha rastet e reja të infeksioneve VHB);
- Infeksione HIV(5% nga të gjitha rastet e reja të infeksioneve HIV).

Zvogëlim i rrezikut nga infeksione të mundshme:

- me mbledhjen e drejtë izolohet burimi i infektionit dhe zvogëlohen sasitë e mbeturinave;
- me paketimin dhe shënimin e drejtë ndalohet përhapja e mëtejshme e infektionit dhe bëhet e ditur se për çfarë lloji mbeturinash bëhet fjalë;
- me ruajtjen e drejtë ndalohet kontakti i ndonjë personi joprofesionist me mbeturinat e rrezikshme ose përzjerja e mbeturinave komunale me ato të rrezikshme;
- me transportimin e drejtë ndalohet kontakti i popullatës me mbeturinat;
- me dokumentimin e të gjithë proceseve rritet niveli i përgjegjësisë të punonjësve, përcaktohen sasitë, llojet e mbeturinave, si dhe shpenzimet të cilat një institucion shëndetësor i bën për mbeturinat.





Përfitimet ekonomike për institucionet shëndetësore:


- Punë e drejtë = zvogëlim i shpenzimeve;
- Mundësi për riciklim;
- Mundësi për ripërdorim.

II.4.2.1. Mjete mbrojtëse për personat të cilët bëjnë transportin e mbeturinave mjekësore

Që të mbrohen nga sëmundjet infektive potenciale, punonjësit shëndetësor e posaçërisht personat të cilët bëjnë transportin e mbeturinave mjekësore duhet të përdorin mjete mbrojtëse personale (Foto 9).

Foto 9

Mbrojtja e rekomanduar për personat të cilët transportojnë mbeturinat mjekësore



Burim: Handbook of hazardous healthcare waste management in 10-bed and 30-bed community hospitals, Thailand. Bangkok. Ministry of Health, 1995; adapted with permission





III. OBLIGIMET E PERSONAVE LIGJOR TË CILËT MENAXHOJNË ME MBETURINAT

Në Ligjin për menaxhim me mbeturinat, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.68/04 dhe 71/04 në Nenin 19 paragrafi 3 është shkruar – personat juridik dhe fizik të cilët menaxhojnë me mbeturinat, të përcaktuar në pajtim me këtë ligj dhe me dispozita të tjera miratojnë **programe për menaxhimin me mbeturinat**.

Në Ligjin për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për menaxhim me mbeturinat, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.107/07 në Nenin 21 paragrafi 1 është shkruar – personat juridik dhe fizik të cilët gjatë një viti kalendarik duke zhvilluar aktivitetin e tyre krijojnë **më shumë se 200 kg. mbeturina të rrezikshme (për institucionet shëndetësore – mbeturina mjekësore)** dhe/ose më shumë se 150 tonelata mbeturina jo të rrezikshme janë të obliguar të përgatisin dhe të realizojnë **Programin për menaxhimin me mbeturinat**, në pajtim me Nenin 19 të këtij Ligji. Në paragrafin 2 të Nenit 21 është shkruar – personat juridik dhe fizik nga paragrafi 1 i këtij Neni janë të obliguar që Programet për menaxhimin me mbeturinat për periudhën e ardhshme t'ua dorëzojnë kryetarëve të komunave dhe Qytetit të Shkupit më së voni gjatë muajit shtator të vitit aktual.

Në paragrafin 3 të Nenit të njëjtë është shkruar – personat juridik dhe fizik programet për menaxhimin me mbeturinat i dorëzojnë edhe tek organi i administratës shtetërore i cili është kompetent për çështjet nga lëmia e ambientit jetësor.

Në paragrafin 4 të Nenit të njëjtë është shkruar – Programi i personave juridik dhe fizik për menaxhimin me mbeturinat përmban:

1. Nivelin ekzistues të krijimit të mbeturinave, sipas llojit, sasisë dhe burimit të krijimit dhe parashikim për llojin dhe sasinë e mbeturinave të cilat do krijohen gjatë vitit të ardhshëm;
2. Masat ekzistuese dhe të planifikuara teknike, organizative dhe masa të tjera për evitimin dhe zvogëlimin e krijimit të mbeturinave dhe zvogëlimin e efektit dëmshëm të mbeturinave;
3. Të dhëna për kapacitetet ekzistuese dhe kapacitetet e planifikuara organizativo-teknike të personave juridik dhe fizik;
4. Masat ekzistuese dhe të planifikuara teknike, organizative dhe masa të tjera (përfshirë këtu edhe investimet) për manipulim me mbeturinat (selektionim, trajtim, përpunim, shfrytëzim i energjisë, deponimi dhe mënjanimi);
5. Afatet kohore për realizimin e detyrave të veçanta të planit për menaxhimin me mbeturinat, afatet kohore për realizimin e fazave të caktuara të planit;
6. Afati kohor për implementimin e standardeve të cilat kanë të bëjnë me përbërjen dhe prodhimin e prodhimeve dhe paketimeve të caktuara dhe përshtatshmëria e tyre për ripërdorim ose për përpunim përfshirë këtu edhe riciklimin;





7. Masa për mbrojtje nga ndikimi i dëmshëm i mbeturinave ndaj ambientit jetësor dhe ndaj shëndetit të njeriut;
8. Aproximin e sistemeve ndërkombëtare për mbrojtje të ambientit jetësor (ISO 14000 e të tjerë);
9. Aktivitetet e planifikuara për edukimin dhe trainimin e kuadrove të cilët menaxhojnë me mbeturinat;
10. Masa të tjera me rëndësi për realizimin e programit për menaxhim me mbeturinat;

Në Ligjin për menaxhim me mbeturinat, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.68/04 dhe 71/04 në Nenin 23 janë përcaktuar **lajmërimet (informimet) për realizimin e programeve për menaxhimin me mbeturinat:**

- paragrafi 4 – personat juridik dhe fizik nga Neni 21 paragrafi 1 i këtij ligji janë të obliguar të dorëzojnë raport vjetor tek kryetari i komunave dhe qytetit të Shkupit për realizimin e programeve të tyre më së voni deri më 31 janar të vitit aktual, për programin e vitit të kaluar.
- paragrafi 5 - personat juridik dhe fizik të Nenit 21 paragrafi 1 të këtij ligji të cilët menaxhojnë me mbeturinat e rrezikshme, raportet nga paragrafi 4 ia dorëzojnë edhe organit të admistratës shtetërore i cili është kompetent për çështjet nga lëmia e ambientit jetësor.

Në Ligjin për menaxhim me mbeturinat, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.68/04 dhe 71/04 në Nenin 24 janë përcaktuar **rregullat për manipulim me mbeturinat.**

Manipulimi me mbeturinat duhet të realizohet me kujdes dhe në atë mënyrë që do mundësojë të evitohet:

- rrezikimi i ambientit jetësor, jetës dhe shëndetit të njerëzve;
- ndotja e ujërave, ajrit dhe tokës jashtë vlerave kufitare të përcaktuara;
- krijimi i zhurmës dhe aromave të pakëndshme.

Në Ligjin për menaxhim me mbeturinat, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.68/04 dhe 71/04 dhe në Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për menaxhimin me mbeturinat, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.107/07 në Nenin 25 është e shkruar **lista e mbeturinave:**

- paragrafi 1 pika 1 mbetjet nga prodhimi ose përdorimi i prodhimeve të cilat nuk janë të pspecifikuara në vazhdim.





Në pajtim me Ligjin për menaxhim me mbeturinat, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.68/04 dhe 71/04, sipas paragrafit 2 të Nenit 25 është përcaktuar **Lista e llojeve të mbeturinave**, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.100/05:

1. Me Listën e llojeve të mbeturinave përcaktohen llojet e mbeturinave, të cilat janë të klasifikuara sipas burimit dhe karakteristikave të tyre.
2. Në këtë Listë mbeturinat janë të grupuara në njëzet grupe me nëngrupet e tyre përkatëse.
 - Grupet kryesore të mbeturinave dhe nëngrupet e tyre në Listë janë të shënuara me shifra dyshifrore, gjegjësisht katërshifrore.
 - Çdo lloj i mbeturinave në këtë listë është i definuar me një shifër gjashtëshifrore.
 - Të gjithë llojet e mbeturinave janë të sistematizuara varësisht nga burimi i krijimit të mbeturinave (veprimtari ekonomike) në grupe nga 01 deri në 12 dhe nga 17 deri në 20 (**mbeturinat mjekësore bëjnë pjesë në grupin 18**).
3. Klasifikimi i mbeturinave bëhet me zgjidhjen e një shifre gjashtëshifrore nga Lista duke ruajtur këtë radhitje:
 - Kontrollohen grupet nga 01 deri në 12 dhe nga 17 deri në 20, duke i përjashtuar shifrat e mbeturinave të cilat mbarojnë me shifrat "99".
 - Procesi i stabilizimit e ndryshon rrezikshmërinë e substancave të mbeturinave, duke i shndërruar kështu ato nga të rrezikshme në jo të rrezikshme. Procesi i ngurtësimit e ndryshon vetëm gjendjen fizike të mbeturinave (për shembull nga të lëngëta në të ngurta) me ndihmën e aditivëve, me ç'rast nuk ndryshohen vetitë kimike të mbeturinave.
 - Mbeturinat konsiderohen si pjesërisht të stabilizuara nëse, pas procesit të stabilizimit, substancat e rrezikshme të mbeturinave nuk janë shndërruar plotësisht në substanca jo të rrezikshme, por mbeturinat mund të derdhen në ambientin jetësor për një afat të shkurtër, të mesëm apo të gjatë kohor.
 - Mbeturinat e rrezikshme në Listë pas shifrës gjashtëshifrore janë të shënuara me yllzë(*).
4. Grupi i Listës (**mbeturina mjekësore**):
 - 18) Mbeturina të cilat krijohen gjatë realizimit të mbrojtjes shëndetësore të njerëzve (18 01) dhe kafshëve (18 02) dhe/ose hulumtime të ngjajshme nga lëmia e mbrojtjes shëndetësore (përveç mbeturinave nga kuzhinat dhe restorantet e që nuk është si rezultat i realizimit të mbrojtjes shëndetësore)
18 01 **mbeturina që krijohen gjatë kujdesit të foshnjave, diagnostifikimit, shërimit ose parandalimit të sëmundjeve tek njerëzit**





18 01 01	mjete të mprehta (përveç 18 01 03)
18 01 02	pjesë të trupit dhe organe të njeriut përfshirë këtu edhe qeskat me gjak (përveç 18 01 03)
18 01 03*	mbeturina mbledhja dhe mėnjanimi i të cilave është lëndë e kërkesave të posaçme për shkak të mbrojtjes nga infektionet
18 01 04	mbeturina mbledhja dhe mėnjanimi nuk është lëndë e kërkesave të posaçme për shkak të mbrojtjes nga infektionet (psh. veshjet, fashat me gips, veshje për një përdorim, pëlhura, vatat etj.)
18 01 06*	kimikalie të bëra nga supstanca të rrezikshme ose që mund të përmbajnë supstanca të rrezikshme
18 01 07	kimikalie që nuk janë përmendur në 18 01 06
18 01 08*	barna citoksike dhe citostatikë
18 01 09	barna që nuk janë përmendur në 18 01 08
18 01 10*	mbeturina të amalgamit gjatë realizimit të mbrojtjes stomatologjike
18 02	mbeturina nga hulumtimet, diagnostikimet, shërimet ose parandalimet e sëmundjeve, përfshirë këtu edhe kafshët
18 02 01	mjete të mprehta (përveç 18 02 02)
18 02 02*	mbeturina mbledhja dhe mėnjanimi i të cilave është lëndë e kërkesave të posaçme për shkak të mbrojtjes nga infektionet
18 02 03	mbeturina mbledhja dhe mėnjanimi i të cilave nuk është lëndë e kërkesave të posaçme për shkak të mbrojtjes nga infektionet
18 02 05*	kimikalie që janë supstanca të rrezikshme ose që mund të përmbajnë supstanca të rrezikshme
18 02 06	kimikalie që nuk janë përmendur në 18 02 05
18 02 07*	barna citoksike dhe citostatikë
18 02 08	barna që nuk janë përmendur në 18 02 07

Në Ligjin për menaxhim me mbeturinat, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.68/04 dhe 71/04, në paragrafin 2 të Nenit 26 është shkruar - nëse mbeturinat kanë një ose më shumë karakteristika të rrezikshme, krijuesi dhe/ose poseduesi ka për që ato mbeturina t'i klasifikojë në kategorinë e mbeturinave të rrezikshme dhe me të të manipulojë si me mbeturina të rrezikshme.

Mėnjanimi i mbeturinave është defnuar në Nenin 34 të ligjit për menaxhimin me mbeturinat, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.68/04 dhe 71/04:

- Mbeturinat të cilat nuk mund të përdoren, përpunohen ose përdoren si burim energjie rishtaz, mėnjanohen me aplikimin e veprimeve të posaçme të përcaktuara në pajtim me Nenin 35 paragrafi 1 i këtij ligji.





- Para se të mënjanoen, mbeturinat duhet t'i nënshtrohen një **trajtimi mekanik, fizik, kimik, termik ose biologjik, me qëllim që të zvogëlohet sasia e mbeturinave, vëllimi i tyre dhe efektet negative ndaj ambientit jetësor, jetës dhe shëndetit të njerëzve.**
- Para se të fillojë mënjanimi i mbeturinave, ato duhet të **selektohen dhe të klasifikohen** në pajtim me Listën e llojeve të mbeturinave.
- Mënjanimi i mbeturinave bëhet në vende të veçanta ose lokacione, si dhe në objekte dhe instalacione të posaçme të ndërtuara për mënjanimin e mbeturinave, të cilët kanë fituar leje ekologjike të integruar A ose B.

Veprimet për mënjanimin e mbeturinave janë të përcaktuara në Nenin 35 të Ligjit për menaxhim me mbeturinat, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.68/04 dhe 71/04:

Paragrafi 1:

- **deponimi** – vendosja në ose mbi tokë (pika 1);
- trajtim biologjik i cili nuk është i definuar në vend tjetër në këtë ligj, e nga i cili rrjedhojnë bashkëdyzimet finale apo përzierjet të cilat mënjanoen me ndonjë nga veprimet të përmendura në pikët 1 deri në 12 të këtij paragrafi (pika 8);
- **trajtimi fiziko-kimik** nuk është i definuar në vend tjetër në këtë ligj, por nga ai rrjedhojnë bashkëdyzime ose përzierje finale të cilat mënjanoen me ndonjë nga veprimet e përmendura në pikat 1 deri 12 të këtij paragrafi (pika 8).

Në paragrafin 2 të të njëjtit Nen është shkruar – mënjanimi i mbeturinave me aplikimin e veprimeve nga paragrafi 1 i këtij Neni do konsiderohet si zgjidhje permanente gjatë menaxhimit me mbeturinat.

Në paragrafin 3 të të njëjtit Nen është shkruar – veprimet nga paragrafi 1 i këtij Neni gjatë importit, eksportit dhe tranzitimit të mbeturinave në dokumentat shoqëruese shënohen me **shkronjë latine (D)** pas të cilës vjen **numri i veprimit përkatës për përpunim** (për institucionet shëndetësore vihet numri **1-deponim**, i cili vjen pas incineracioni të kryer për mbeturinat mjekësore nga institucionet shëndetësore në Shkup dhe Kumanovë, ndërsa për institucionet shëndetësore të qyteteve të tjera shënohet ashtu siç është e shënuar në Udhëzuesin për menaxhimin me mbeturinat në çastin e publikimit të tij, gjegjësisht vetëm me deponimin e tij pas përfundimit të ndarjes dhe autoklavimit të mbeturinave infektive).





Në Ligjin për menaxhim me mbeturinat, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.68/04 dhe 71/04 dhe në Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për menaxhimin me mbeturinat, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.107/07 në Nenin 38 janë shkruar kushtet për **menaxhues me mbeturinat**:

1. Personat juridik dhe fizik nga Neni 21 paragrafi 1 i këtij ligji janë të obliguar të angazhojnë persona të cilët posedojnë autorizim për menaxhues të mbeturinave.
2. Menaxhuesi me mbeturinat është përgjegjës para organeve kompetente për realizimin e punëve që kanë të bëjnë me menaxhimin me mbeturinat.
3. Menaxhuesi me mbeturinat:
 - ndërmerr masa dhe aktivitete për evitimin dhe për zvogëlimin e sasive të mbeturinave të krijuara;
 - i mbikqyr procedurat të cilat aplikohen gjatë trajtimit dhe gjatë përpunimit të mbeturinave – që nga krijimi deri në mënjanimin e tyre;
 - kontrollon krijimin e mbeturinave gjatë proceseve teknologjike;
 - kontrollon zbatimin e e procedurave për përpunimin e mbeturinave;
 - kontrollon llojin dhe sasinë e mbeturinave të cilat krijohen, përpunohen dhe mënjanohen;
 - zbaton metoda dhe procedura për përpunimin dhe zvogëlimin e karakteristikave të rrezikshme të mbeturinave;
 - përcjell gjendjen aktuale të menaxhimit me mbeturinat;
 - i informon organet udhëheqëse të personave juridik dhe fizik për rrezikun e mundshëm ndaj ambientit jetësor, jetës dhe shëndetit të njerëzve, e i cili është rezultat i prodhimit, trajtimit, përpunimit dhe mënjanimin të mbeturinave dhe propozon zgjidhje konkrete;
 - e zbaton programin vjetor të personave juridik dhe fizik të nenit 21 të këtij ligji dhe është përgjegjës për menaxhimin e drejtë me mbeturinat.
4. Punët e menaxhuesit me mbeturinat mund t'i kryejë person me arsim të lartë nga fusha e shkencave natyrore ose teknike, me përvojë tre vjeçare në menaxhimin me mbeturinat.
5. Autorizimi për kryerjen e punëve të menaxhuesit me mbeturinat fitohet pas marrjes së provimit profesional, të cilit personi i nënshtrohet para një komisioni të përbërë nga Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore përgjegjës për çështjet nga lëmia e ambientit jetësor.
6. Komisioni nga paragrafi 5 i këtij Neni është i përbërë nga 5 anëtarë të cilët kanë së paku përvojë pesë vjeçare nga lëmia e menaxhimit me mbeturinat.





7. Personit i cili ka marrë provimin profesional i jepet vërtetim për menaxhues me mbeturinat.
8. Organi i administratës shtetërore përgjegjës për çështjet nga lëmia e ambientit jetësor mund të anulojë (tërheqë) vërtetimin për kryerjen e veprimtarisë së menaxhuesit me mbeturinat, për personin i cili ka keqpërdorur pozitën e tij në pajtim me ligjin.
9. Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore përgjegjës për çështjet nga lëmia e ambientit jetësor miraton programin sipas të cilit personat i nënshtrohen provimit profesional dhe përcakton mënyrën e realizimit të provimit profesional për menaxhues me mbeturinat, formularin e vërtetimit për menaxhues me mbeturinat, si dhe lartësinë dhe mënyrën e pagesës së taksës për dhënien e provimit profesional.

Obligimit për menaxhues me mbeturinat i nënshtrohen të gjitha Shtëpitë e shëndetit, Spitalet e përgjithshëm, Spitalet e specializuar dhe Klinikat spitalore. Në nivel të ish ISHP Qendrës klinike-Shkup përgjegjës për menaxhues me mbeturinat për të gjithë Klinikat shëndetësore është personi i autorizuar nga Institucionet Publike të shërbimeve të përgjithshme për nevojat e ISHP Klinikave dhe institucioneve – Shkup.

Në bazë të Nenit 38 paragrafi 8, Ministri për ambientin jetësor dhe planifikimin hapsinor miratoi – Rregulloren për programin dhe mënyrën e dhënies së provimit profesional për menaxhues me mbeturinat, formularin për dhënien e provimit profesional për menaxhues me mbeturinat, formularin për vërtetim, si dhe lartësinë dhe mënyrën e pagesës së taksës për provimin profesional për menaxhues me mbeturinat, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.105/05 (si dhe korrigjimin nr.109/05 dhe ndryshimin dhe plotësimin nr.133/07 janë të dhënë te shtojca nr.1).

Në Ligjin për menaxhim me mbeturinat, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.68/04 dhe 71/04 në Nenin 39 është caktuar **obligimi për evidentim dhe lajmërim:**

1. Personat juridik dhe fizik të cilët bëjnë mbledhjen, transportimin, ruajtjen, trajtimin, përpunimin, mënjanimin dhe shkëmbimin (import, eksport dhe tranzitim) e mbeturinave janë të obliguar të mbajnë evidencë për:
 - Llojin, sasinë dhe prejardhjen e mbeturinave me të cilat manipulojnë;
 - Mbeturinat e magazinuara përkohësisht;
 - Mbeturinat të cilat i janë dorëzuar mbledhësit dhe transportuesit të mbeturinave;
 - Mbeturinat të cilat janë shfrytëzuar ose përpunuar nga vetë krijuesit e mbeturinave;





- Mbeturinat të cilat janë dorëzuar tek persona të tjerë juridik dhe fizik të cilët bëjnë përpunimin e mbeturinave , nëse përpunimi nuk bëhet nga vetë krijuesi i mbeturinave;
 - Të dhënat për aplikimin e veprimeve për përpunim nga Neni 35 paragrafi 1 i këtij ligji;
 - Mbeturinat të cilat duhet të mënjahohen;
 - Mbeturinat të cilat përpunohen ose mënjahohen jashtë shtetit;
 - Për destinacionin fillestar dhe atë të fundit të transportimit të mbeturinave dhe
 - Sasitë dhe llojet e mbeturinave të cilat janë importuar, eksportuar ose që kanë tranzituar në/nga/nëpër Republikën e Maqedonisë.
2. Evidenca nga paragrafi 1 i këtij Neni kryhet për çdo ditë në ditar.
 3. **Personat juridik dhe fizik nga paragrafi 1 i këtij Neni kanë për detyrë që personit të autorizuar për transportimin e mbeturinave gjatë dorëzimit të mbeturinave për transport t'i japin formularë identifikues dhe për transport të mbeturinave.**
 4. Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore përgjegjës për çështjet nga lëmia e ambientit jetësor përcakton formën, përmbajtjen dhe mënyrën e përdorimit të formularëve nga paragrafi 1 i këtij Neni.
 5. Personat juridik dhe fizik nga paragrafi 1 i këtij Neni kanë për detyrë që formularët nga paragrafi 3 i këtij Neni t'i ruajnë si pjesë përbërëse e dokumentacionit të plotë për manipulimin me mbeturinat.
 6. Personat juridik dhe fizik nga paragrafi 1 i këtij Neni kanë për detyrë që, një herë në vit, të dhënat nga evidentimet – në formë të një raporti të konsoliduar në një formular të përcaktuar – t'i dorëzojnë tek organi përgjegjës për kryerjen e çështjeve profesionale nga lëmia e ambientit jetësor, më së voni deri në 31 janar të vitit aktual për vitin e kaluar.
 9. Personat juridik dhe fizik kanë për detyrë që të dhënat e evidentimit nga paragrafi 1 i këtij Neni t'i ruajnë më së paku 5 vjet.
 10. Formën dhe përmbajtjen e formularëve nga paragrafi 6 i këtij Neni i përcakton Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore përgjegjës për çështjet nga lëmia e ambientit jetësor.

Në bazë të Nenit 39, paragrafi 4 dhe 10, Ministri i ambientit jetësor dhe planifikimit hapsinor miratoi – Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e ditarit për evidentimin e manipulimeve me mbeturinat, formën dhe përmbajtjen e formularëve për identifikimin dhe transportin e mbeturinave dhe përmbajtjen e formularëve për raportet vjetore për manipulimet me mbeturinat, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.146/07 (Shtojca nr.2).





Bo Ligjin për menaxhim me mbeturinat, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 68/04 dhe 71/04 dhe në Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për menaxhim me mbeturinat, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.107/07 në Nenin 45 paragrafi 3 është shkruar – për kryerjen e veprimtarisë mbledhje dhe transport të mbeturinave komunale dhe llojeve të tjera të mbeturinave jo të rrezikshme, subjektet nga paragrafi 1 i këtij Neni duhet të kenë të punësuar së paku një person që ka përgatitje profesionale në pajtim me rregullat për regjistrimin e kryerjes së veprimtarisë, si dhe të disponojnë me mjete materialo-teknike për kryerjen e veprimtarisë.

Në Ligjin për menaxhim me mbeturinat, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.68/04 dhe 71/04 në Neni 57 janë përcaktuar **rregullat për manipulimin me mbeturinat e rrezikshme:**

1. **Veprimet ndaj mbeturinave të rrezikshme bëhen veçmas nga llojet e tjera të mbeturinave.**
2. Ndalohet derdhja dhe hedhja e mbeturinave të rrezikshme në tokë, në ujëra, në enët për mbeturina komunale, sistemet infraqstrukturore të kanalizimit dhe sisteme dhe objekte të tjera infraqstrukturore, si dhe magazinimi dhe mënjanimi i tyre në vende të cilat nuk janë bërë për atë qëllim.
3. Ndalohet djegia ose ndezja e mbeturinave të rrezikshme në vende të cilat nuk janë të parapara për këtë qëllim si dhe përdorimin e mjeteve dhe instalimeve të cilat gjatë djegies mund ta rrezikojnë ambientin jetësor, jetën dhe shëndetin e njerëzve.
4. Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore përgjegjës për çështjet nga lëmia e ambientit jetësor i përcakton kushtet për manipulimin me mbeturinat e rrezikshme.

Në Ligjin për menaxhim me mbeturinat, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.68/04 dhe 71/04 në Nenin 57 është caktuar **paketimi dhe shënimi adekuat i mbeturinave të rrezikshme:**

1. Mbeturinat e rrezikshme të cilat janë të dedikuara për transportim, përpunim, magazinim ose mënjanim, detyrimisht duhet të jenë **të paketuara dhe të shënuara sipas rregullave**, me qëllim që të mundësohet një mbrojtje e plotë e ambientit jetësor, jetës dhe shëndetit të njerëzve.
2. Mbeturinat e rrezikshme paketohen në enë të posaçme, të konstruara varësisht nga lloji i mbeturinave (që ndizen lehtë, që janë eksplozive, infektive etj.), në të cilat detyrimisht duhet të qëndrojë shenja “Mbeturina të rrezikshme”.
3. Ministri i ambientit jetësor dhe planifikimit hapsinor përcakton mënyrën e paketimit dhe shënimit të mbeturinave të rrezikshme.





4. Ndalohet transporti i mbeturinave të rrezikshme të cilat nuk janë të paketuara dhe të shënuara në pajtim me këtë ligj dhe dispozitat e miratuara në bazë të këtij ligji.

Në bazë të Nenit 57, paragrafi 4 dhe Neni 64, paragrafi 3, Ministri i ambientit jetësor dhe planifikimit hapsinor miratoi-Rregulloren për kushtet e manipulimit me mbeturinat e rrezikshme dhe mënyrën e paketimit dhe shënimit të mbeturinave të rrezikshme, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.15/08.

Në Ligjin për menaxhim me mbeturinat, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.68/04 dhe 71/04 dhe në Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për menaxhim me mbeturinat, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.107/07 **evidentimi dhe klasifikimi i detyrueshëm i mbeturinave të rrezikshme** është përcaktuar në Nenin 60:

1. **Krijuesi i mbeturinave të rrezikshme** dhe personat juridik dhe fizik të cilët manipulojnë me mbeturinat e rrezikshme janë të obliguar të mbajnë evidencë, në pajtim me Nenin 39 të këtij ligji, posaçërisht **evidencë të karakteristikave të rrezikshme të mbeturinave të rrezikshme të krijuara dhe t'i klasifikojnë ato sipas Listës së llojeve të mbeturinave.**
2. Krijuesi, poseduesi dhe përpunuesi mbajnë evidencë për mbeturinat e rrezikshme të cilat janë të magazinuara në vendin ku ato janë krijuar, gjegjësisht ku i janë dorëzuar personit publik ose juridik të autorizuar për mbledhjen dhe transportimin e mbeturinave të rrezikshme.
3. Operatori i deponisë dhe operatori i instalacioneve për mënjanimin e mbeturinave të rrezikshme janë të obliguar të evidentojnë dhe të identifikojnë mbeturinat e rrezikshme të pranuar për mënjanim.
4. Të dhënat nga paragrafi 1, 2 dhe 3 të këtij Neni, në formë të raportit, një herë në vit dorëzohen tek organi kompetent për kryerjen e çështjeve profesionale nga lëmia e ambientit jetësor në pajtim me Nenin 39 të këtij ligji.
5. Personat juridik dhe fizik nga paragrafi 1, 2 dhe 3 të këtij Neni, të cilët menaxhojnë me mbeturinat e rrezikshme, janë të obliguar të ruajnë të dhënat në pajtim me Nenin 39 të këtij ligji së paku për pesë vjet.

Në Ligjin për menaxhim me mbeturinat, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.68/04 dhe 71/04 në Nenin 61 është përcaktuar **formulari identifikues për mbeturinat e rrezikshme:**

1. Personat juridik dhe fizik të cilët manipulojnë me mbeturinat e rrezikshme janë të obliguar të japin **formular identifikues** dhe të njëjtin ta shoqërojnë me raport për karakteristikat e mbeturinave, nëse mbeturinat janë të dedikuara për transportim, në pajtim me Nenin 39 të këtij ligji.





2. Personat juridik dhe fizik të cilët manipulojnë me mbeturinat e rrezikshme janë përgjegjës për saktësinë e të dhënave të shënuara në formularin identifikues të paragrafit 1 të këtij Neni.
3. Personat juridik dhe fizik të cilët manipulojnë me mbeturinat e rrezikshme nuk kanë të drejtë të pranojnë mbeturinat pa pranuar formularin identifikues.
4. Personat juridik dhe fizik të cilët manipulojnë me mbeturinat e rrezikshme janë të obliguar të dorëzojnë një kopje të formularit identifikues tek organi kompetent për kryerjen e çështjeve profesionale nga lëmia e ambientit jetësor.

Në Ligjin për menaxhim me mbeturinat, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.68/04 dhe 71/04 dhe në Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për menaxhim me mbeturinat, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.107/07 **manipulimi me mbeturinat** është përcaktuar në Nenin 73:

- (1) **me mbeturinat mjekësore manipulohet sipas dispozitave për mbeturina të rrezikshme të këtij ligji.**
- (2) Mbeturinat e rrezikshme nga objektet në të cilat realizohet mbrojtje shëndetësore e njerëzve përfshijnë mbeturinat infektive, kimike dhe farmaceutike, si dhe barnat citostatike, mjetet e mprehta dhe lloje të tjera të mbeturinave të rrezikshme.
- (3) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore përgjegjës për çështjet nga lëmia e ambientit jetësor, në pajtim me Ministrin e shëndetësisë, më saktë do e përcaktojë mënyrën e manipulimit me mbeturinat mjekësore, shënimin dhe formularët për manipulimin me mbeturinat mjekësore, si dhe llojet e mbeturinave mjekësore, përpunimi i të cilëve është i ndaluar.
- (4) Programet për menaxhimin me mbeturinat nga objektet për mbrojtje shëndetësore dhe veterinare i miraton Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore përgjegjës për çështjet nga lëmia e shëndetësisë, gjegjësisht Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore përgjegjës për çështjet nga lëmia e shëndetësisë veterinare në pajtim me Ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore përgjegjës për çështjet nga lëmia e ambientit jetësor.
- (5) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore përgjegjës për çështjet nga lëmia e ambientit jetësor në pajtim me Ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore përgjegjës për çështjet nga lëmia e shëndetësisë dhe Ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore përgjegjës për çështjet nga lëmia e shëndetësisë veterinare përcakton mënyrën e manipulimit me mbeturinat mjekësore, si dhe mënyrën e paketimit dhe shënimit të mbeturinave mjekësore.





Në bazë të Nenit 73 paragrafi 5 Ministri i shëndetësisë dhe Ministri i bujqësisë, pyjeve dhe administrimit të ujërave miratoi Rregullore për mënyrën e manipulimit me mbeturinat mjekësore, si dhe si dhe mënyrën e paketimit dhe shënimit të mbeturinave mjekësore, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.146/07 (Shtojca nr.3).

Në Nenin 90, paragrafi 3 i Ligjit për menaxhim me mbeturinat, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.68/2004 dhe 71/04 është shkruar – Qeveria e Republikës së Maqedonisë e miraton **lartësinë e pagesës nga Lista e tarifave për deponimin e mbeturinave të rrezikshme.**

Në Nenin 120, paragrafi 1 i Ligjit për menaxhim me mbeturinat, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.68/2004 dhe 71/04 janë përcaktuar burimet e financimit: realizimi i planeve dhe programeve të Republikës së Maqedonisë për menaxhimin me mbeturinat financohet me mjetet e siguruara nga buxheti i Republikës së Maqedonisë, kredi, donacione, **mjete të personave juridik dhe fizik të cilët menaxhojnë me mbeturinat**, pagesa nga burime të tjera të mjeteve të përcaktuara me ligj.

Në paragrafin 3 të Nenit 120 të të njëjtit ligj është shkruar – mjetet për ndërtimin e hapësirave, objekteve dhe instalacioneve për magazinim, përpunim dhe për mënjanim të mbeturinave të rrezikshme sigurohen nga buxheti i Republikës së Maqedonisë, nga personat juridik dhe fizik të cilët menaxhojnë me mbeturinat, kredi, donacione burime të tjera të mjeteve të përcaktuara me ligj.

Në Nenin 121 paragrafi 5 të Ligjit për menaxhim me mbeturinat, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.68/2004 dhe 71/04 është shkruar – personat juridik dhe fizik nga Neni 20 paragrafi 1 i këtij ligji, çmimin për mbledhjen dhe transportimin e mbeturinave jo të rrezikshme e përcaktojnë në kontratën e lidhur me personat juridik dhe fizik të autorizuar për mbledhjen dhe transportimin e mbeturinave, bazuar në sasinë dhe llojin e mbeturinave të krijuara të shprehur në denarë për metër kub ose denarë për tonelatë mbeturina.





VI. MBIKQYRJA INSPETORIALE GJATË MENAXHIMIT ME MBETURINAT MJEKËSORE

Në Ligjin për menaxhim me mbeturinat, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.68/04 dhe 71/04 dhe Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për menaxhim me mbeturinat, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.107/07 në Nenin 126 janë përcaktuar organet kompetente për mbikqyrje të zbatimit të këtij ligji për menaxhimin me mbeturinat:

(4) Mbikqyrjen inspektoriale mbi zbatimin e këtij ligji në pjesën e krijimit, selekcionimit dhe paketimit të mbeturinave mjekësore e realizon **Inspektorati shtetëror shëndetësor dhe sanitar**, në bashkëpunim me **Inspektorin shtetëror për ambientin jetësor**.

(6) Mbikqyrjen inspektoriale mbi zbatimin e këtij ligji në pjesën e lënies, hedhjes, braktisjes dhe/ose mënjanimin të pakontrolluar e të paligjshëm të mbeturinave, si dhe djegia e mbeturinave në ambiente të hapura e realizojnë inspektorët komunalë të komunës, komunave të qytetit të Shkupit dhe Qyteti i Shkupit.

Në Ligjin për menaxhim me mbeturinat, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.68/04 dhe 71/04 në Nenin 127 është përcaktuar fushëveprimi i Inspektoriatit shtetëror për ambientin jetësor dhe atë:

(1) Në kryerjen e mbikqyrjes nga fushëveprimi i tij, **inspektori shtetëror për ambientin jetësor** ka të drejtë të:

- 1) të konstatojë nëse janë përpiluar programet për menaxhimin me mbeturinat për vitin aktual dhe nëse të njëjtat janë dorëzuar tek organi kompetent për kryerjen e çështjeve nga lëmia e ambientit jetësor (Neni 21 paragrafi 3);
- 2) të konstatojë nëse është dorëzuar raporti vjetor për zbatimin e programeve tek organi kompetent për kryerjen e çështjeve nga lëmia e ambientit jetësor (Neni 23 paragrafi 5);
- 3) të rishikojë dhe të kontrollojë nëse në instalacionet me leje të integruar B me mbeturinat e rrezikshme manipulohet në pajtim me Nenin 24 të këtij ligji;
- 4) të rishikojë dhe të kontrollojë nëse mbledhja dhe transportimi i mbeturinave të rrezikshme kryhet me mjete dhe pajisje të konstruara dhe që përdoren vetëm për mbledhjen dhe transportin e mbeturinave të rrezikshme (Neni 27);
- 5) të rishikojë dhe të kontrollojë nëse mbeturinat përpunohen në pajtim me Nenin 29 të këtij ligji;





- 6) të konstatojë nëse kanë leje për magazinim, trajtim dhe përpunim të mbeturinave në pajtim me Nenin 32 të këtij ligji dhe nëse veprimtaria kryhet në pajtim me lejen e dhënë;
- 7) të rishikojë dhe të kontrollojë nëse mbeturinat e rrezikshme magazinohen në vendet e parapara për këtë qëllim në pajtim me Nenin 33 të këtij ligji;
- 8) të rishikojë dhe të kontrollojë nëse në instalacionet me leje të integruar ekologjike B me mbeturinat e rrezikshme manipulohet në pajtim me Nenin 34 të këtij ligji;
- 10) të konstatojë **nëse personat juridik dhe fizik nga Neni 21 i këtij ligji kanë angazhuar menaxhues me mbeturinat, si dhe nëse i njëjti posedon vërtetim për menaxhues për mbeturinat** në pajtim me Nenin 38 të këtij ligji;
- 11) të rishikojë dhe të kontrollojë nëse evidentimi kryhet në mënyrë të përcaktuar në Nenin 39 të këtij ligji për mbeturina të rrezikshme;
- 12) të konstatojë nëse dorëzohet një raport i konsoliduar në pajtim me Nenin 39 paragrafi 6 i këtij ligji;
- 13) të rishikojë dhe të kontrollojë të dhënat e evidentimeve për mbeturina të rrezikshme nga instalacionet me leje të integruar ekologjike B, si dhe të konstatojë nëse të dhënat e evidentohen në pajtim me Nenin 38 paragrafi 10 i këtij ligji;
- 19) të rishikojë dhe të kontrollojë nëse me mbeturinat e rrezikshme manipulohet në pajtim me Nenin 57 të këtij ligji;
- 20) të rishikojë dhe të kontrollojë nëse mbeturinat e rrezikshme përzihen me lloje të tjera të mbeturinave të rrezikshme dhe nëse mbeturinat e rrezikshme përzihen me mbeturina jo të rrezikshme (Neni 58);
- 21) të konstatojë nëse organi i administratës shtetërore përgjegjës për çështjet nga lëmia e ambientit jetësor është lajmëruar në rast të përzierjes së mbeturinave të rrezikshme me lloje të tjera të mbeturinave, substanca dhe materjale (Neni 59);
- 22) të rishikojë dhe të kontrollojë nëse evidentimi bëhet në pajtim me Nenin 60 të këtij ligji;
- 23) të konstatojë nëse plotësohen obligimet për dhënien e formularëve identifikues për mbeturina të rrezikshme (Neni 61);
- 26) të rishikojë dhe të kontrollojë nëse mbeturinat e rrezikshme të cilat janë të destinuara për transportim, magazinim, përpunim dhe mënjanim janë të paketuara dhe të shënuara në mënyrë të duhur (Neni 64);
- 27) të konstatojë nëse është bërë kontratë me persona juridik të cilët posedojnë leje për mbledhjen dhe transportimin e mbeturinave të rrezikshme (Neni 65).





Në Ligjin për menaxhim me mbeturinat, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.68/04 dhe 71/04 në Nenin 132 është përcaktuar fushëveprimi i **Inspektoriatit shtetëror sanitar dhe shëndetësor** dhe atë:

- (1) Në kryerjen e mbikqyrjes në fushëveprimin e tij, Inspektori shtetëror sanitar dhe shëndetësor ka të drejtë:
 - **Të rishikojë nëse personat juridik dhe fizik bëjnë mbledhjen, selekcionimin dhe paketimin e mbeturinave mjekësore** në pajtim me këtë ligj.
- (2) Inspektoriati shtetëror sanitar dhe shëndetësor kryerjen e mbikqyrjes inspektoriale nga paragrafi 1 i këtij Neni, e realizon në pajtim me Ligjin për inspektim sanitar dhe shëndetësor dhe këtë ligj.

Në **Ligjin për inspektim sanitar dhe shëndetësor**, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.71/06 është shkruar:

- Në Nenin 4 paragrafi 12 është përcaktuar **që inspektorati sanitar dhe shëndetësor të kryejë mbikqyrje të krijimit, selekcionimit, paketimit dhe mënjanimin të mbeturinave mjekësore.**
- Në Neni 14 të të njëjtit ligj është përcaktuar se Personat juridik dhe fizik të cilët kryejnë veprimtari ose profesion të pavarur, janë të obliguar të mundësojnë kryerje të vazhdueshme të mbikqyrjes inspektoriale dhe me kërkesë të inspektorit të japin të dhëna të vërteta dhe të sakta, informata, kampione dhe materjale të tjera, pa pagesë, si dhe të mundësojnë marrje të përkohëshme të dokumentacionit ose gjëseneve të tjera të cilat mund të shërbejnë si prova gjatë një procesi gjyqësor.
- Në Nenin 15 të të njëjtit ligj është shkruar se në kryerjen e mbikqyrjes inspektoriale, inspektori është i autorizuar t'i kontrollojë të gjitha ambientet punuese dhe ato ndihmëse, gjëgjësisht ambientet, dokumentacionin, evidencën e kryer, pajisjet si dhe mjetet për punë të cilat i nënshtrohen mbikqyrjes inspektoriale, të kërkojë deklaratë nga punonjësit përgjegjës, deklaratë nga dëshmitarët, kampione për analizë, strishio, e në rast nevojë të përdorë edhe shërbime të personave juridik profesionistë të tjerë.
- Në Nenin 16 të të njëjtit ligj është shkruar se Inspektori e kryen mbikqyrjen inspektoriale pa ndonjë lajmërim paraprak, por para fillimit të kryerjes së vetë mbikqyrjes ka për detyrë të lajmërojë personin përgjegjës për kryerjen e mbikqyrjes inspektoriale dhe të legjitimohet.
- Në Nenin 17 të të njëjtit ligj është shkruar:
 1. deri në mënjanimin e mangësive sanitaro-higjienike është i ndaluar përdorimi i ambienteve punuese dhe publike, pajisjeve dhe mjeteve të cilat kanë ndikim negativ ndaj jetës dhe shëndetit të njeriut;





2. mund të urdhërojnë mënjanim të mangësive, gjegjësisht parregullsive në pajtim me ligjet dhe dispozitat e tjera me të cilat rregullohet mbrojtja e shëndetit të njerëzve;
 3. mund të urdhërojnë zbatim të masave sanitaro-higjienike për shkak të ndalimit ose zhdukjes së sëmundjeve ngjitëse;
 8. mund të urdhërojnë mënjanimin e mangësive, gjegjësisht parregullsive gjatë kryerjes së dezinfektimit dhe sterilizimit në institucionet shëndetësore ose institucione të tjera;
 11. mund të ndalojnë punën e pajisjeve dhe objekteve të cilët lirojnë materje të dëmshme ose në ndonjë mënyrë tjetër negativisht ndikojnë në shëndetin dhe jetën e njerëzve;
 12. mund të ndalojnë kryerjen e veprimtarisë shëndetësore nëse e njëjta kryhet në kundërshtim me rregullat për mbrojtje shëndetësore;
 13. mund të ndër marrin edhe masa të tjera për të cilat janë të autorizuar me ligj dhe dispozita të tjera.
- Në Nenin 18 të të njëjtit ligj është shkruar – nëse gjatë kryerjes së mbikqyrjes inspektoriale inspektori vërteton thyerje të ligjit ose të ndonjë dispozite tjetër mbi zbatimin e të cilëve kryen mbikqyrje organ tjetër i administratës shtetërore, ai njofton organin kompetent të administratës shtetërore (Ministrinë e shëndetësisë).
 - Në Nenin 19 të të njëjtit ligj është shkruar se inspektori është përgjegjës nëse:
 1. gjatë kryerjes së mbikqyrjes inspektoriale me vendim nuk urdhëron marrjen e masave dhe veprimeve të cilat sipas ligjit është i obliguar t'i ndërmarrë;
 2. i ka tejkalar kompetencat ligjore;
 3. ka keqpërdorur postin zyrtar;
 4. nuk lajmëron organet kompetente për parregullsitë e zbuluara;
 5. nuk legjitimohet para fillimit të kryerjes së mbikqyrjes inspektoriale.
 - Procedura për vërtetimin e përgjegjësisë disiplinore të inspektorit kryhet në pajtim me Ligjin për nëpunësat shtetëror.
 - Neni 21 – Mbikqyrjen inspektoriale inspektori e kryen përmes:
 - ◇ mbikqyrjes së rregullt inspektoriale (Neni 22 – mbikqyrja e rregullt inspektoriale përfshin zbatim të ligjeve dhe dispozitave të tjera nga lëmia e mbrojtjes sanitaro higjienike, epidemiologjike dhe asaj shëndetësore, sigurimit shëndetësor dhe evidencave nga lëmia e shëndetësisë nga ana e personave juridik dhe fizik të cilët janë të obliguar të zbatojnë këto dispozita);





- ◇ mbikqyrjes të jashtëzakonshme inspektoriale (Neni 23 – mbikqyrja e jashtëzakonshme inspektoriale kryhet në bazë të iniciativave, propozimeve të dhëna nga organet shtetërore, personat juridik dhe fizik, si dhe në raste rreziku të paraqitjes së ndonjë epidemie dhe kushte të tjera të përcaktuara nga Inspektorati);
- ◇ Mbikqyrjes inspektoriale kontrolluese (Neni 24 – mbikqyrje inspektoriale kontrolluese kryhet pas mbarimit të afatit të caktuar në vendimin e marrë nga Inspektorati).
- Neni 25
 - ◇ Për mbikqyrjen inspektoriale të kryer, të dhënat e fituara dhe konstatimet për gjendjen aktuale, inspektori është i obliguar të formulojë proces verbal.
 - ◇ Nëse inspektori konstaton se nuk zbatohen ligjet, dispozitat dhe aktet e tjera, ai sjell vendimin me të cilin urdhëron ndërmarrjen e disa masave të caktuara për një kohë të caktuar nga inspektorati.
 - ◇ Inspektori është i obliguar që palës mbi të cilën është kryer mbikqyrja inspektoriale t'i dorëzojë kopje të proces verbalit dhe vendimit;
- Neni 26 – Gjatë kryerjes së mbikqyrjes inspektoriale, inspektorët veprojnë sipas dispozitave të Ligjit për procedurën administrative të përgjithshme, përveç në rastet kur kjo gjë është përcaktuar ndryshe me këtë ligj.
- Neni 27
 - ◇ Në rastet kur do të vërtetohet ekzistenca e rrezikut për shëndetin dhe jetën e njerëzve, inspektorët japin urdhër gojor për mënjanim urgjent dhe të paevitueshëm të mangësive, e cila shënohet në proces verbal.
 - ◇ Në rastet nga paragrafi 1 i këtij Neni, inspektorët marrin vendimin në afat kohor prej 48 orësh nga dhënia e urdhërit gojor.
- Neni 28
 - ◇ Kundër vendimit të inspektorit mund të bëhet ankesë drejtuar Ministrit të shëndetësisë në afat kohor prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.
 - ◇ Ministri i shëndetësisë më së voni në afat kohor prej 15 ditësh nga dita e pranimit të ankesës, do sjellë vendim sa i përket ankesës.
 - ◇ Ankesa nga paragrafi 1 i këtij Neni nuk e ndalon zbatimin e vendimit.
- Neni 29
 - ◇ Nëse gjatë kryerjes së mbikqyrjes inspektoriale inspektori konstaton se sipas ligjit ose ndonjë dispozite tjetër është bërë shkelje ose vepër penale është i obliguar që menjëherë të bëjë kërkesë për fillimin e procedurës penale, gjegjësisht denoncimin për vepër penale.





- ◇ Organi kompetent tek i cili kryhet procedura penale nga paragrafi 1 i këtij Neni, është i obliguar që ta lajmërojë inspektorin për rrjedhën dhe rrezultatit e procedurës.
- ◇ Nëse gjatë kryerjes së mbikqyrjes inspektoriale inspektori konstaton shkelje për të cilën me ligj të veçantë është caktur dënim mandatar, atëherë ai jep dënim mandatar në vetë vendin e shkeljes së ligjit.
- Neni 31:
 - ◇ Me dënim nga 50.000 deri në 250.000 denarë do të dënohet për shkelje personi juridik nëse:
 - ◇ Pengon kryerjen e mbikqyrjes inspektoriale dhe në kërkesë të inspektorit nuk jep të dhëna të sakta dhe të vërteta, informata, kampione dhe materjale të tjera, pa pagesë ose pengon marrjen e përkohëshme të dokumentacionit ose gjësëndeve të tjera të cilat mund të shënrbëjnë si prova gjatë procedurës gjyqësore(Neni 14) dhe
 - ◇ Nuk vepron sipas urdhërit gojor të dhënë nga inspektori për mënjanim të menjëhershëm dhe urgjent të mangësive në rast të ekzistimit të një rreziku për jetën dhe shëndetin e njerëzve. (Neni 27 paragrafi 1).
 - ◇ Për shkeljen nga paragrafi 1 i këtij Neni do të dënohet me gjobë nga 10.000 deri në 50.000 denarë edhe personi fizik i cili kryen veprimtari ose profesion të pavarur.
 - ◇ Për shkeljen nga paragrafi 1 i këtij Neni me gjobë nga 10.000 deri në 50.000 denarë edhe personi përgjegjës për personin juridik.

Në **Ligjin për mbrojtje të popullatës nga sëmundjet infektive**, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.37/06 dhe ndryshimin dhe plotësimin 139/08 është shkruar:

Neni 49:

- Monitorimi i infeksioneve intraspitalore dhe ndërmarrja e masave për ndalimin e paraqitjes dhe zhdukjen e tyre është obligim i çdo institucioni shëndetësor.
- Drejtori i institucionit shëndetësor është përgjegjës për ndalimin dhe zhdukjen e infeksioneve intraspitalore.
- Drejtori është i obliguar të formojë komision për monitorimin e infeksioneve intraspitalore dhe të miratojë program për ndalimin dhe zhdukjen e infeksioneve intraspitalore.
- Programi nga paragrafi 3 i këtij Neni përmban:
 - 3) realizim doktrinar të sterilizimit, dezinfektimit, pastrimit, si dhe **manipulimit të sigurtë me mbeturinat mjekësore dhe mbeturinat e tjera.**





Neni 61:

- Paragrafi 2 – Mbikqyrjen inspektorale mbi zbatimin e këtij ligji dhe dispozitave të miratuara në bazë të tij e realizon **Inspektorati shtetëror sanitar dhe shëndetësor.**

Neni 66:

- Me gjobë nga 50.000 deri më 250.000 denarë do të dënohet për shkelje personi juridik, nëse:
- 10) nuk e ndjek situatën dhe nuk ndërmerr masa për ndalimin dhe zhdukjen e infeksioneve intraspitalore ose në ndonjë mënyrë tjetër nuk vepron në pajtim me Nenin 49 të këtij ligji;

Në bazë të Nenit 32 paragrafi 4 pika 1 të Ligjit për mbrojtje shëndetësore, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.38/91, 46/93, 55/95, 10/04, 84/05, 111/05, 65/06 dhe 05/07 është miratuar **Programi për mbrojtje shëndetësore parandaluese në Republikën e Maqedonisë për vitin 2009**, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.3/09 në të cilin është shkruar se veprimtarinë sanitaro-higjienike e realizojnë Enti republikan për mbrojtje shëndetësore dhe Entet për mbrojtje shëndetësore dhe se ata do të ndjekin procesin e mënjanimit të mbeturinave të ngurta dhe të lëngëta përfshirë këtu edhe mbeturinat mjekësore, do të mbikqyrin objektet dhe vendet e mënjanimit, përpunimit dhe dispozimit përfundimtar të mbeturinave.

Në Ligjin për menaxhim me mbeturinat, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.68/04 dhe 71/04 dhe Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për menaxhim me mbeturinat, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.107/07 në Nenin 132-c është përcaktuar përgjegjësia e personave zyrtar dhe atë:

- 2) Nëse gjatë realizimit të masave dhe procedurave të përcaktuara me këtë ligj, konstatohen shkelje nga ana e personit juridik ose fizik që janë si rezultat i veprimeve dhe/ose mosrealizimit dhe/ose lëshimit të mbikqyrjes së obligueshme ndaj një personi tjetër i cili ka qënë i autorizuar të veprojë në emër të personit juridik, si dhe paraqitje e të dhënave dhe dokumentave jo të sakta dhe jo të vërteta, personat zyrtar janë të obliguar të iniciojnë ose të bëjnë kërkesë për denoncim penal në pajtim me dispozitat e këtij ligji.
- 3) Personat juridik dhe fizik për të cilët janë parashikuar të drejta dhe obligime të përcaktuara me këtë ligj, në rast se konstatojnë shkelje ose tejkallim të kompetencave nga ana e personave zyrtar nga paragrafi 1 i këtij Neni, si rezultat i veprimeve dhe/ose mosrealizimit, janë të obliguar për këtë gjë ta lajmërojnë Ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për çështjet nga lëmia e ambientit jetësor, gjegjësisht kryetarin e komunës, të qytetit të Shkupit dhe të komunave të qytetit të Shkupit.





Në Ligjin për menaxhim me mbeturinat, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.68/04 dhe 71/04 në Nenin 136 janë përcaktuar obligimet për personat juridik dhe fizik:

- 1) Personat juridik dhe fizik të cilët menaxhojnë me mbeturinat janë të obliguar që inspektorit të ambientit jetësor dhe inspektorit të autorizuar për ambientin jetësor t'i mundësojnë realizim pa pengesa të mbikqyrjes dhe t'ia dorëzojnë do kumentacionin e plotë, t'i japin sqarime dhe informata shtesë të cilat i kanë në dispozicion, dhe që janë në interes të realizimit të mbikqyrjes inspektoriale.
- 2) Për mbikqyrjen inspektoriale të kryer, inspektori për ambientin jetësor dhe inspektori i autorizuar për ambientin jetësor është i obliguar të formulojë proces verbal për rrezultatet e konstatuara dhe një kopje të proces verbalit të dorëzojë tek personi përgjegjës i personit juridik tek i cili është realizuar mbikqyrja inspektoriale dhe tek organi i administratës shtetërore kompetent për çështjet nga lëmia e ambientit jetësor.

Masat ndëshkuese për mosveprimin në pajtim me Ligjin për menaxhimin me mbeturinat, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.68/04 dhe 71/04 dhe Ligjin për ndryshimin dhe Ligjin për menaxhim me mbeturinat, Gazeta zyrtare e -Republikës së Maqedonisë nr.107/07 janë përcaktuar në Nenin 139:

Paragrafi 1 dhe atë – me gjobë në vlerë prej 2.000 euro të shprehur në denarë do të dënohet personi juridik i cili menaxhon me mbeturinat, nëse:

- (1) nuk përpilon programe për menaxhimin me mbeturinat për vitin aktual dhe të njëjtit nuk i dorëzon tek organet kompetente (Neni 21);
- (2) nuk dorëzojnë raport vjetor për zbatimin e programeve të tyre për menaxhimin me mbeturinat (Neni 23 paragrafi 5);
- (4) hedh, braktis, djeg ose në mënyrë të pakontrolluar mënjanon mbeturina,
- (Neni 24-a);
- (8) nuk angazhon menaxhues për mbeturinat (Neni 38);
- (9) nuk evidenton dhe nuk i ruan të dhënat për evidentimin e mbeturinave (Nenet 39 dhe 60);
- (13) nuk kanë lidhur kontratë për dhënësin e shërbimeve ose me person juridik dhe fizik të autorizuar për mbledhjen dhe transportimin e mbeturinave (Nenet 43 dhe 65).





Paragrafi 2 dhe atë – me **gjobë në vlerë prej 3.000 euro** të shpreur në denarë do të dënohet personi juridik i cili menaxhon me mbeturinat, nëse:

- (1) nuk i selekcionon dhe nuk i klasifikon mbeturinat e rrezikshme, sipas llojit dhe karakteristikave të përcaktuara në Listën e llojeve të mbeturinave dhe vepron në kundërshtim me dispozitat e Nenet 26 të këtij ligji;
- (3) nuk i magazinon mbeturinat e rrezikshme në vendet, objektet ose në instalacionet e dedikuara për atë qëllim (Neni 33);
- (5) para mënjanimit nuk i trajton mbeturinat e rrezikshme (Neni 34 paragrafi 2);
- (7) të dhënat për mbeturinat e rrezikshme nuk i dorëzon një hetë në vit tek organi i administratës shtetërore kompetent për çështjet nga lëmia e ambientit jetësor (Nenet 39 dhe 60);
- (8) nuk manipulon ndarazi me mbeturinat e rrezikshme (Neni 57);
- (9) i derdh dhe/ose hedh mbeturinat e rrezikshme në ujë, tokë, në enë të cilat nuk janë të parapara për mbledhjen e llojeve të caktuara të mbeturinave, në kanalizime dhe në sisteme dhe objekte të tjera infrastrukturore (Neni 57);
- (10) përzien mbeturinat e rrezikshme me lloje të tjera të mbeturinave të rrezikshme dhe përzien mbeturina të rrezikshme me mbeturina jo të rrezikshme (Neni 58);
- (11) nuk e lajmëron organin kompetent në rast se mbeturinat e rrezikshme janë përzier me lloje të tjera të mbeturinave dhe fillon me procedurën për veçimin e tyre pa leje (Neni 59);
- (12) krijuesi dhe/ose poseduesi i mbeturinave të rrezikshme nu dorëzon formular identifikues me të dhëna për llojin, vendin e krijimit, sasinë dhe mënyrën e paketimit të mbeturinave të rrezikshme (Neni 61);
- (29) **me mbeturinat mjekësore manipulon në kundërshtim me Nenin 73 të këtij ligji.**

Paragrafi 3 – me gjobë në vlerë prej 400 euro të shprehur në denarë do të dënohet personi përgjegjës i personit juridik i cili manipulon me mbeturinat për veprimet e paragrafit 1 të këtij Neni.

Paragrafi 4 – me gjobë në vlerë prej 500 euro të shprehur në denarë do të dënohet personi përgjegjës i personit juridik i cili manipulon me mbeturinat për veprimet e paragrafit 2 të këtij Neni.

Në pajtim me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për menaxhim me mbeturinat (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.143/08) dhe Nenin 32 të të njëjtit ligj, paragrafi 10 është përcaktuar se **“Personat juridik dhe fizik nga paragrafi 1 i këtij Neni janë të obliguar të vendosin video kamera në vendin e pranimit të mbeturinave, si dhe në pozita të tjera të vendit ose objekteve përmes të cilave do të evidentohet pranimi, manipulimi dhe ruajtja e mbeturinave”.**





Në kontekst me atë që thamë dhe në funksion të parandalimit dhe mbrojtjes së shëndetit të punonjësve të cilët marrin pjesë në transportin lokal dhe në trajtimin e mbeturinave mjekësore, si dhe punonjësve të NP Higjiena komunale-Shkup të cilët i pranojnë, transportojnë dhe incinerojnë mbeturinat mjekësore nga klinikat, enti dhe qendra e urgjencës në suaza të IP Klinikat universitare, Enti dhe Qendra e urgjencës-Shkup është e nevojshme të vendosen video kamera tek depoja e Klinikës së kardiologjisë dhe depoja tek Klinikat kirurgjikale për monitorimin dhe ndalimin e parregullsive të mundshme gjatë trajtimit të mbeturinave mjekësore, gjë për të cilën janë paraparë edhe gjopa për personin juridik nëse nuk veprohet sipas rregullave.

Aktet nënligjore të cilat janë në interes të menaxhimit të sigurtë me mbeturinat mjekësore janë të dhëna në tekstin në vijim.

Rregullore për formën dhe përmbajtjen e ditarit për evidencën për manipulimin me mbeturinat, formën dhe përmbajtjen e formularëve për identifikim dhe transport të mbeturinave dhe formën dhe përmbajtjen e formularëve të raporteve vjetor për manipulimin me mbeturinat, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.7/06.

Rregullore për programin dhe mënyrën e dhënies së provimit profesional për menaxhues me mbeturinat, formular për dhënien e provimit profesional për menaxhues me mbeturinat, formular për vërtetim, si dhe sasia dhe mënyra e pagesës së taksës për dhënien e provimit profesional për menaxhues me mbeturinat, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.105/05.

Korrigjim i rregullores për programin dhe mënyrën e dhënies së provimit profesional për menaxhues me mbeturinat, formular për dhënien e provimit profesional për menaxhues me mbeturinat, formular për vërtetim, si dhe sasia dhe mënyra e pagesës së taksës për dhënien e provimit profesional për menaxhues me mbeturinat, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.109/05.

Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Regullores për programin dhe mënyrën e dhënies së provimit profesional për menaxhues me mbeturinat, formular për dhënien e provimit profesional për menaxhues me mbeturinat, formular për vërtetim, si dhe sasia dhe mënyra e pagesës së taksës për dhënien e provimit profesional për menaxhues me mbeturinat, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.133/07.

Rregullore për formën dhe përmbajtjen e kërkesës për marrjen e lejes për përpunim, trajtim dhe/ose magazinim të mbeturinave, formatin dhe përmbajtjen dhe e lejes kushtet minimale teknike, trajtim ose magazinim të mbeturinave, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.23/07.





Rregullore për mënyrën dhe kushtet për magazinim të mbeturinave, si dhe kushtet të cilat duhet t'i plotësojnë vendet në të cilat do magazinohen mbeturinat, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.29/07.

Rregullore për kushtet më të hollësishme për manipulimin me mbeturinat e rrezikshme dhe mënyrën e paketimit dhe shënimit të mbeturinave të rrezikshme, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.15/08.





V. LITERATURA

1. Council Directive 91/689/EEC of 12 December 1991 on hazardous waste. Brussels; 1991.
2. Council Directive 94/67/EC of 16 December 1994 on the incineration of hazardous waste. Brussels; 1994.
3. Елаборат за состојбата со опасни материјали од здравствените установи во Скопје и нивното безбедно депонирање. Републички завод за здравствена заштита. Скопје; 1996.
4. Кендровски В., Кочубовски М., Ѓорѓев Д., Фиљански П., Велев Д. Прирачник за управување со медицинскиот отпад. Републички завод за здравствена заштита. Скопје; 1999: 4-26.
5. Kochubovski M. Kendrovski V. Evaluacija bezbednosnog upravljanja medicinskog cvrstog otpada nastalog u medicinskim ustanovama u Skoplju, Republika Makedonija. Medjunarodna konferencija Otpadne vode, komunalni cvrsti otpad i oaspan otpad, Tara; 2002: 379-383.
6. Lista e llojeve të mbeturinave. Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.100/05.
7. Правилник за програмата и начинот за полагање стручен испит за управител со отпад, образец на уверение, како и висина и начин на плаќање на надоместокот за полагање на стручен испит за управител со отпад. Службен весник на Република Македонија бр.105/05.
8. Исправка на Правилникот за програмата и начинот за полагање стручен испит за управител со отпад, образец на уверение, како и висина и начин на плаќање на надоместокот за полагање на стручен испит за управител со отпад. Службен весник на Република Македонија бр.109/05.
9. Правилник за изменување и дополнување на Правилникот за програмата и начинот за полагање стручен испит за управител со отпад, образец на уверение, како и висина и начин на плаќање на надоместокот за полагање на стручен испит за управител со отпад. Службен весник на Република Македонија бр.133/07.
10. Правилник за формата и содржината на дневникот за евиденција за постапување со отпад, формата и содржината на формуларите за идентификација и транспорт на отпадот и формата и содржината на обрасците за годишни извештаи за постапување со отпад. Службен весник на Република Македонија бр.07/06.
11. Правилник за формата и содржината на барањето за добивање на дозвола за преработка, третман и/или за складирање на отпад, формата и содржината на дозволата како и минималните технички услови за вршење на дејноста преработка, третман и/или складирање на отпад. Службен весник на Република Македонија бр.23/07.
12. Правилник за поблиските услови за постапување со опасниот отпад и начинот на пакување и означување на опасниот отпад. Службен весник на Република Македонија бр.15/08.






13. Програма за превентивна здравствена заштita во Република Македонија за 2009 година. Службен весник на Република Македонија бр.3/09.
14. Ligji për mbrojtjen e natyrës. Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.67/04.
15. Ligji për menaxhim me mbeturinat. Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.68/04.
16. Ligji për inspektimin sanitar dhe shëndetësor. Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.71/06.
17. Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për ambientin jetësor. Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.24/07.
18. Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për menaxhimin me mbeturinat. Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.107/07.
19. Ligji për mbrojtjen e popullatës nga sëmundjet ngjitëse. Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.37/06.
20. Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për mbrojtjen e popullatës nga sëmundjet ngjitëse. Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.139/08.
21. Ligji për sigurinë dhe shëndetin gjatë punës. Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.92/07.
22. Ligji për mbrojtje shëndetësore. Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.17/97, 11/02, 10/04, 84/05, 111/05, 65/06, 05/07).
23. Ligji për shëndetësi publike veterinarë. Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.114/07.
24. WHO. Safe management of wastes from health-care activities. Geneva; 1999.
25. www.who.int
26. www.epa.gov
27. www.healthcarewaste.org
28. <http://europa.eu.int/eur-lex/en>
29. www.moep.gov.mk
30. www.iph.mk
31. Teachers's Guide, Management of wastes from health-care activities. WHO, Geneva; 1998.
32. Guidelines for the Safe Disposal of Unwanted Pharmaceuticals in after Emergencies. WHO, Geneva; 1999.
33. Starting Health care Waste Management in Medical Institutions a Practical Approach. WHO, Copenhagen; 2000.





SHTOJCA:





Shtojca nr.1

Rregullore për programin dhe mënyrën e dhënies së provimit profesional për menaxhues me mbeturinat, formular për dhënien e provimit profesional për menaxhues me mbeturinat, formular për vërtetim, si dhe sasia dhe mënyra e pagesës së taksës për dhënien e provimit profesional për menaxhues me mbeturinat, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.105/05. (si dhe korigjimi nr.109/05 dhe ndryshimi dhe plotësimi nr.133/07 janë pjesë e shtojcës nr.1).

Në bazë të Nenit 38 paragrafi nga Ligji për menaxhimin me mbeturinat ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " nr.68/04 dhe 71/04), Ministri për ambientin jetësor dhe planifikimin hapsinor miratoi

RREGULLORE

për programin dhe mënyrën e dhënies së provimit profesional për menaxhues me mbeturinat, formular për dhënien e provimit profesional për menaxhues me mbeturinat, formular për vërtetim, si dhe sasia dhe mënyra e pagesës së taksës për dhënien e provimit profesional për menaxhues me mbeturinat

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohen programi dhe mënyra e dhënies së provimit profesional për menaxhues me mbeturinat, formulari i vërtetimit dhe mënyra e pagesës së taksës për provimin profesional për menaxhues me mbeturinat.

Neni 2

Provimi profesional për fitimin e autorizimit për menaxhues me mbeturinat jipet sipas programit, i cili është dhënë në shtojcën numër 1 dhe është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje. Procedura e dhënies së provimit përbëhet nga dy pjesë: pjesën profesionale-normative dhe pjesën praktike.

Neni 3

Për dhënien e provimit, kandidati parashktron kërkesë tek Ministria e ambientit jetësor dhe planifikimit hapsinor.

Kërkesa ka këto elemente:

1. Emri dhe mbiemri;
2. Data dhe vendi i lindjes;
3. Adresa e banimit;
4. Numri i banorit nga libri i amzës;





5. Vërtetim që është paguar taksa për dhënien e provimit profesional;
Bashkë me kërkesën, kandidati dorëzon edhe këto dokumenta:
 6. Diplomë për mbarimin e arsimit të lartë nga lëmia e shkencave natyrore dhe teknike;
 7. Vërtetim për përvojë pune pesë vjeçare në lëminë e menaxhimit me mbeturinat.
- Dokumentat nga pikat 5, 6 dhe 7 nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij Neni dorëzohen në original, gjegjësisht fotokopje e vërtetuar ose duplikat.

Neni 4

Provimi jepet para komisionit për dhënien e provimit profesional për menaxhues me mbeturinat. (Në tekstin në vazhdim: Komisioni).

Për punën e tij komisioni mban **Ditar**.

Provimi mbahet në ambientet e Ministrisë së ambientit jetësor dhe planifikimit hapsinor.

Komisioni përmes një shpalljeje në dy gazetatat ditore më të shitura si dhe në faqen e internetit të Ministrisë së ambientit jetësor dhe planifikimit hapsinor shpall kohën dhe afatin e dhënies së provimit.

Neni 5

Kandidati i cili ka paraqitur provimin mund të heqë dorë nga dhënia e provimit, më së voni deri në 10 ditë nga dita e caktuar për dhënien e provimit.

Kandidatit i cili nuk është paraqitur në provim e i cili nuk e ka lajmëruar në kohë Ministrinë e ambientit jetësor dhe planifikimit hapsinor se heq dorë nga provimi, taksa e paguar për dhënien e provimit nuk i kthehet.

Neni 6

Provimi realizohet me shkrim ndërsa me vendim të Komisionit mund të realizohet edhe gojarisht. Para fillimit të provimit, sekretari i Komisionit vërteton identitetin e kandidatëve në provim.

Komisioni, në prani të kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit, secilit nga kandidatëve ju dorëzon pyetjet e provimit, gjegjësisht testin me shkrim, i cili ndodhet në një zarf të vulosur.

Në pjesën me shkrim të provimit marrin pjesë vetëm Komisioni dhe kandidatët të cilët i nënshtrohen provimit.

Sekretari i Komisionit, në prani të kryetarit dhe Anëtarëve të Komisionit, secilit nga kandidatëve ua dorëzon pyetjet, gjegjësisht testin me shkrim, të vendosura në një zarf të vulosur.

Në pjesën me shkrim të provimit marrin pjesë vetëm Komisioni dhe kandidatët të cilët i nënshtrohen provimit.

Gjatë provimit, nuk është e lejuar që kandidatët të bisedojnë mes veti, të përdorin mjete të palejuara, as edhe të lëshojnë ambientin në të cilin realizohet provimi.





Neni 7

Punimin me shkrim kandidati e dorëzon gjatë kohës së përcaktuar për provim, që fillon nga çasti kur dorëzohen pyetjet, gjegjësisht testet.

Kandidati i cili gjatë kohës nga paragrafi 1 i këtij Neni nuk e ka punuar punimin e tij me shkrim, e dorëzon atë tek Komisioni.

Neni 8

Komisioni i kontrollon punimet me shkrim dhe vlerëson nëse kandidati ka fituar pikët e nevojshme të cilat janë 80% nga numri i përgjithshëm i pikëve dhe të cilat janë kusht për kalimin në pjesën praktike të provimit.

Nëse kandidati ka fituar 60% deri në 80% të pikëve, atëherë ai mund të vazhdojë në pjesën praktike të provimit.

Neni 9

Pjesa gojore e provimit realizohet, sipas rregullit, po të njëjtën ditë, ndërsa më së voni deri në 8 ditë nga dita e përfundimit të pjesës me shkrim të provimit.

Në pjesën gojore të provimit, rradhitjen e kandidatëve e cakton kryetari i Komisionit.

Neni 10

Kandidati i cili nuk do i nënshtrohet pjesës me gojë ose nuk paraqitet fare në provim, do të konsiderohet sikur nuk e ka kaluar provimin.

Nëse, kandidati i cili i ka pranuar pyetjet e pjesës gojore të provimit heq dorë nga i njëjti, konsiderohet se nuk e ka kaluar provimin.

Neni 11

Suksesin e kandidatit Komisioni e vlerëson me shkrim në bazë të rrezultateve që ai ka treguar në provim dhe atë: "e ka kaluar" ose "nuk e ka kaluar". Gjatë vërtetimit të suksesit të arritur nga ana e kandidatit aplikohet tabela e pikëve në vijim:

Lëmia e programit	Numri maksimal i pikëve të mundshme	Numri minimal i pikëve për kalimin e provimit:	
		Pikët	%
Pjesa me shkrim: 1,2,3,4,5,6 dhe 7	100	60	60%
Pjesa gojore: 8	30	18	60%

Neni 12

Kandidati i cili në fund të provimit nuk ka treguar rezultate të kënaqshme nga një lëmi e caktuar programore, mund t'i nënshtrohet riprovimit vetëm për atë lëmi.

Afati për dhënien e riprovimit nuk mund të jetë më i shkurtër se 1 muaj, por as më i gjatë se 3 muaj.





Kandidati i cili nuk i nënshtrohet riprovimit ose në riprovim nuk tregon rezultate të kënaqshme në afatin kohor të caktuar në paragrafin 1 të këtij Neni, atëherë konsiderohet se ai kandidat nuk e ka kaluar provimin.

Neni 13

Për kandidatët të cilët kanë kaluar provimin për marrjen e autorizimit për menaxhues të mbeturinave, Ministria e ambientit jetësor dhe planifikimit hapsinor jep Vërtetime.

Vërtetimi për kalimin e provimit profesional jipet më së voni në afat kohor prej 1 muaji nga dita e mbajtjes së provimit profesional.

Formularin i Vërtetimit marrjen e autorizimit për menaxhues të mbeturinave është dhënë në shtojcën nr. 2 dhe është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

Neni 14

Formulari i vërtetimit për menaxhues të mbeturinave përmban:

- Stema e Republikës së Maqedonisë;
- Mbishkrimin Republika e Maqedonisë – Ministria e ambientit jetësor dhe planifikimit hapsinor;
- Emri dhe mbiemri i personit i cili i është nënshtuar provimit për menaxhues të autorizuar për mbeturinat;
- Numri i amzës;
- Vendi dhe data e lindjes;
- Dita e marrjes së provimit dhe fitimit të titullit menaxhues i autorizuar për mbeturinat para Komisionit të Ministrisë të Ambientit jetësor dhe planifikimit hapsinor;
- Numri nën të cilin është evidentuar në Ministrinë e ambientit jetësor dhe planifikimit hapsinor dhe
- Firma e Ministrit.

Neni 15

Pagesa për dhënien e provimit profesional për menaxhues me mbeturinat është 3.000,00 denarë. Pagesa për dhënien e një pjese të provimit profesional, në përputhje me Nenin 12 të kësaj rregulloreje është 1.500,00 denarë.

Neni 16

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e tetë nga publikimi i saj në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndërsa do aplikohet nga data 01.06.2007.

Nr. 07-5133/1
18 nëntor, viti 2005
Shkup

Ministër,
Dr. Zoran Shapuriq





Shtojca 1

PROGRAMI PËR DHËNIEN E PROVIMIT PROFESIONAL PËR MENAXHUES TË AUTORIZUAR ME MBETURINAT

Lëmia I: TEMA PËR PJESËN PROFESIONALO-NORMATIVE TË PROVIMIT

1. Prioritetet në menaxhimin me mbeturinat
2. Parimi i mbrojtjes të ambientit jetësor gjatë menaxhimit me mbeturinat
3. Sistem i kaucionit
4. Menaxhimi me mbeturinat
5. Të drejtat dhe obligimet e personave juridik dhe fizik që kanë të bëjnë me menaxhimin me mbeturinat
6. Mënyra dhe kushtet në të cilat mund të bëhet mbledhja, transportimi, trajtimi, përpunimi, magazinimi dhe mënjanimi i mbeturinave, eksporti dhe tranzitimi i mbeturinave, monitorimi, sistemi informativ dhe financimi
7. Planifikimi i menaxhimit me mbeturinat (planet, programet)
8. Organe të administratës shtetërore
9. Vetëqeverisja lokale

Lëmia I-a:

1. Bazat e Window 2003, Microsoft Word 2003 dhe Microsoft Excel 2003

Lëmia II: TEMA PËR PJESËN PROFESIONALE-PRAKTIKE TË PROVIMIT

1. Njohuri bazë për organizimin e veprimtarive komunale
2. Normat teknike bazë për kryerjen e veprimtarisë komunale
3. Karakteristikat e mbeturinave komunale
4. Teknologjia e deponimit
5. Njohja e pajisjeve bashkëkohore dhe automjeteve për grumbullim, transport dhe deponim të mbeturinave komunale

Listë e literaturës së nevojshme për përgatitjen e provimit:

- Ligji për ambientin jetësor (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.53/05)
- Ligji për mbeturina (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.68/04 dhe 71/04)
- Ligji për veprimtari komunale (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.45/97, 23/99, 45/02, 14/04)
- Ligji për ndërmarrje publike (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.38/96, 6/02, 40/03)





- Ligji për vetëqeverisje lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.5/02)
- Direktiva për mbeturinat
- Konventa e Bazelit në lidhje me kontrollin ndaj ndotjes jashtë kufijve të caktuar me mbeturina të rrezikshme dhe deponimi i tyre
- Konventa është ratifikuar me Ligjin për ratifikim të publikuar në (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.49/04)
- Amandmani i Konventës së Bazelit që ka të bëjë me kontrollin e ndotjes jashtë kufijve të caktuar me mbeturina të rrezikshme dhe deponimin e tyre dhe Amandmani i Aneksit I, Aneksit VIII dhe Aneksit IX/ Amendment to the Basel
- Convention on the Control of Transboundary Movements of Hazardous Wastes and their Disposal
- Amandmanet janë ratifikuar me Ligjin për ratifikim (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.49/04)
- PANE 1 dhe PANE 2
- Strategjia nacionale për menaxhimin e mbeturinave
- Lista e llojeve të mbeturinave.

Shtojca 2



REPUBLIKA E MAQEDONISË
MINISTRIA E AMBIENTIT JETËSOR DHE PLANIFIKIMIT HAPSINOR

VËRTETIM
PËR MARRJEN E PROVIMIT PROFESIONAL
MENAXHUES ME MBETURINA

me NUMRIN E AMZËS _____, i/e lindur në _____
_____ në _____ në datë
_____ para Komisionit të Ministrisë të ambientit jetësor dhe planifikimit hapsinor
kaloi provimin profesional dhe fitoi titullin Menaxhues me mbeturina.

Shkup _____

Ministër

Numër _____





Pas krahasimit me tekstin fillestar është konstatuar se në tekstin e Rregullores për programin dhe mënyrën e dhënies së provimit profesional për menaxhues me mbeturinat, formular për dhënien e provimit profesional për menaxhues me mbeturinat, formular për vërtetim, si dhe sasia dhe mënyra e pagesës së taksës për dhënien e provimit profesional për menaxhues me mbeturinat ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.05/05), është bërë gabim dhe për këtë arsye jipet

KORRIGJIM I RREGULLORES
për programin dhe mënyrën e dhënies së provimit profesional për menaxhues me mbeturinat, formular për dhënien e provimit profesional për menaxhues me mbeturinat, formular për vërtetim, si dhe sasia dhe mënyra e pagesës së taksës për dhënien e provimit profesional për menaxhues me mbeturinat.

Në Nenin 16 pas tekstit: "do të zbatohet nga 1.06.2007" në vend të numrit "2007" duhet të qëndrojë numri "2006".

Nr. 07-5133/2
7 dhjetor 2005
Shkup

Ministër,
Dr. Zoran Shapuriq

Në bazë të Nenit 38 paragrafit nga Ligji për menaxhimin e mbeturinave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.68/04, 71/04 dhe 107/07), Ministri i ambientit jetësor dhe planifikimit hapsinor miratoi

RREGULLORE PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES
për programin dhe mënyrën e dhënies së provimit profesional për menaxhues me mbeturinat, formular për dhënien e provimit profesional për menaxhues me mbeturinat, formular për vërtetim, si dhe sasia dhe mënyra e pagesës së taksës për dhënien e provimit profesional për menaxhues me mbeturinat

Neni 1

Në Rregulloren për programin dhe mënyrën e dhënies së provimit profesional për menaxhues me mbeturinat, formular për dhënien e provimit profesional për menaxhues me mbeturinat, formular për vërtetim, si dhe sasia dhe mënyra e pagesës së taksës për dhënien e provimit profesional për menaxhues me mbeturinat ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.105/05), në Nenin 3 paragrafi 1 fjala "personi i cili parashton kërkesën" zëvendësohet me fjalën "kandidat".

Neni 2

Në Nenin 5 pas paragrafit 1 shtohen edhe dy paragrafë të ri, 2 dhe 3 të cilët janë siç vijon:
"(2) Provimi mund të anulohet ose të shtyhet për shkak të ndonjë sëmundjeje, aksidenti, rast





vdekjeje në familje ose për arsye të tjera për të cilat kandidati Komisionit i dorëzon prova.

(3) Për rëndësinë e arsyeve për anulimin e provimit vendos Komisioni.”

Në paragrafin 2 i cili bëhet 4 fjalët: “nuk e ka lajmëruar Ministrinë e ambientit jetësor dhe planifikimit hapsinor” zëvendësohen me fjalët “ nuk e ka lajmëruar Komisionin”.

Neni 3

Në Neni 14 pas alinesë 7 shtohet aline e re në të cilën shkruan:“numri i regjistrimit”.

Neni 14

Pas Neni 14 shtohet Neni 14-a në të cilin shkruan:

“Neni 14-a

(1) Për vërtetimet e dhëna mbahet evidencë e cila përmban:

- numër rendor, Emri dhe mbiemri i personit të cilit i lipet vërtetimi dhe

- data e dhënies së vërtetimit dhe Vërejtje në të cilën shënohen ndryshimet e të dhënave.

(2) Numri rendor në të cilin janë evidentuar të dhënat shënohet te Vërtetimi si numër i tij i regjistrimit”

Neni 7

Kjo rregullore hyn në fuqi një ditë pas publikimit të saj në “ Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë”.

Nr. 07-5834

9 tetor 2007

Shkup

Ministër,
Xhelil Bajrami





Shtojca nr.2

Rregullore për formën dhe përmbajtjen e ditarit për evidencën për manipulimin me mbeturinat, formën dhe përmbajtjen e formularëve për identifikim dhe transport të mbeturinave dhe formën dhe përmbajtjen e formularëve të raporteve vjetor për manipulimin me mbeturinat, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.7/06.

Në bazë të Nenit 39 paragrafi 4 dhe 10 të Ligjit për menaxhim me mbeturinat ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " nr. 68/04 dhe 71/04), Ministri i ambientit jetësor dhe planifikimit hapsinor miratoi

RRGULLORE PËR FORMËN DHE PËRMBAJTJEN E DITARIT PËR EVIDENCËN PËR MANIPULIMIN ME MBETURINAT, FORMËN DHE PËRMBAJTJEN E FORMULARËVE PËR IDENTIFIKIM DHE TRANSPORT TË MBETURINAVE DHE FORMËN DHE PËRMBAJTJEN E FORMULARËVE TË RAPORTEVE VJETOR PËR MANIPULIM ME MBETURINAT

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohet forma dhe përmbajtja e ditarit për evidencën për manipulimin me mbeturinat, forma dhe përmbajtja e formularëve për identifikimin dhe transporti e mbeturinave dhe forma dhe përmbajtja e formularëve të raporteve vjetor për manipulim me mbeturinat.

Neni 2

Ditari për evidencën për manipulimin me mbeturinat (në tekstin e mëposhtëm ditari) shërben për evidentimin e manipulimeve me mbeturinat.

Ditari është në formë A-4 në ngjyrë të bardhë.

Përmbajtja e ditarit është e dhënë në formularin si shtojcë nr. 1 e kësaj rregulloreje dhe është pjesë përbërëse e saj.

Operatori i deponisë mban ditar në një formular të veçantë për manipulimet me mbeturinat.

Përmbajtja e këtij formulari nga paragrafi 4 i këtij Neni është dhënë si Shtojca nr. 6 në këtë rregullore dhe është pjesë përbërëse e saj.

Ditari është në formë të shkruar dhe elektronike.





Neni 3

Gjatë transportit të mbeturinave për çdo lloj të veçantë të mbeturinave jipet formular identifikues i veçantë.

Formulari identifikues për mbeturinat jipet në format A-4 në ngjyrë të bardhë.

Përmbajtja e formularit identifikues për mbeturinat është dhënë si Shtojca nr. 2 e kësaj rregulloreje dhe është pjesë përbërëse e saj.

Neni 4

Formulari i transportit të mbeturinave jipet gjatë transportit të çdo lloji të mbeturinave. Formulari i transportit të mbeturinave jipet në format A-4 në ngjyrë të gjelbër.

Përmbajtja e formularit të transportit të mbeturinave është dhënë si shtojca nr. 3 e kësaj rregulloreje dhe është pjesë përbërëse e saj.

Neni 5

Të dhënat nga evidentimi ditor i manipulimit me mbeturinat plotësohen në formularë për raporte vjetore për manipulimin me mbeturinat nga persona juridik dhe fizik dhe është në format A-4 në ngjyrë të bardhë.

Përmbajtja e formularit për raportin vjetor për manipulimin me mbeturinat nga persona juridik dhe fizik është dhënë si Shtojca nr. 4 e kësaj rregulloreje dhe është pjesë përbërëse e saj.

Raportin vjetor nga evidentimi ditor i manipulimit me mbeturinat për një deponi, operatori i deponisë e dorëzon në një formular të veçantë. Formulari për raportin vjetor për manipulimin me mbeturinat për një deponi është në formatin A-4 në ngjyrë të bardhë.

Përmbajtja e formularit nga paragrafi 5 i këtij Neni është dhënë në Shtojca nr. 7 e kësaj rregulloreje dhe është pjesë përbërëse e saj.

Raportet vjetore nga paragrafi 1 dhe 4 i këtij Neni dorëzohen në formë të shkruar dhe elektronike.

Neni 6

Kryetari i komunave dhe i qytetit të Shkupit, raportin vjetor për manipulimin me mbeturinat e dorëzon në një formular të veçantë në formë të shkruar dhe elektronike.





Formulari për raportin vjetor për manipulimin me mbeturinat nga kryetari i komunave dhe qytetit të Shkupit është në format A-4 në ngjyrë të bardhë.

Përmbajtja e formularit nga paragrafi 5 i këtij Neni është dhënë në Shtojca nr. 5 e kësaj rregulloreje dhe është pjesë përbërëse e saj.

Neni 7

Kjo rregullore hyn në fuqi nga dita e publikimit të saj në "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", ndërsa do të zbatohet nga 01.01.2007.

Nr. 07-5697
22 dhjetor 2005
Shkup

Ministër
D-r Zoran Shapuriq





Shtojca 1

DITAR PËR EVIDENTIMIN E MANIPULIMEVE ME MBETURINAT

Titulli/emri: _____

Adresa: _____ Data: _____

Tabela 1 - Mbeturina të pranuar nga persona të tjerë

Nr. Rendor	Shifra	Përsh. i mbeturinave	Lloji i mbeturinave	Prejardhja e mbeturinave të pranuar	Sasia e mbeturinave të pranuar		Sasia e mbeturinave nga importi		Manipulime të mëtejshme
					t	m ³	t	m ³	
1	2	3	4	5	6		7		8

Shënim:

Personi përgjegjës:

Tabela 2 - Mbeturina të krijuara

Nr. Rendor	Shifra	Përsh. i mbeturinave	Lloji i mbeturinave	Prejardhja e mbeturinave të krijuara	Manipulime me mbeturinat							
					Deponim personal		Magazininim i përkohshëm		Manipulime të mëtejshme			
					t	m ³	t	m ³	t	m ³	Shën.	
1	2	3	4	5	6		7		8			

Shënim:

Personi përgjegjës:





Tabela 3 - Mbeturina të dorëzuara te persona të tjerë

Nr. Rendor	Shifra	Përsh. i mbeturinave	Lloji i mbeturinave	Subjekti të cilit i janë dorëzuar mbeturinat	Sasia e mbeturinave të dorëzuara		Sasia e mbeturinave të eksportuara		Manipulime të mëtejshme
					t	m ³	t	m ³	
1	2	3	4	5	6		7		8
Shënim:									

Personi përgjegjës:

Tabela 3 - Të dhëna për trajtimet

Nr. Rendor	Shifra	Përsh. i mbeturinave	Lloji i mbeturinave	Përshkrim i trajtimit	Sasia e mbeturinave të trjtuara		Mbetje gjatë trajtimit		
					t	m ³	t	m ³	
1	2	3	4	5	6		7		
Shënim:									

Personi përgjegjës:





UDHËZUES PËR PLOTËSIMIN E DITARIT PËR EVIDENTIMIN E MANIPULIMIT ME MBETURINAT

Në nënpjesën e ditarit plotësohen titulli/emri dhe adresa e personit juridik dhe fizik, posedues i mbeturinave dhe data e plotësimit të të dhënave.

Tabela 1, në këtë Tabelë plotësohen të dhënat për mbeturinat të pranuar nga persona juridik dhe fizik të tjerë, ashtu që:

- **Kolona 1**, plotësohet numri rendor në veçanti për secilin Lloj të mbeturinave si shifër e parë dhe numri i tabelës si shifër e dytë (sh. 1/1, 2/1, 3/1 etj).
- **Kolona 2**, për çdo lloj të veçantë të mbeturinave plotësohet shifra gjashtëshifrore nga Lista e llojeve të mbeturinave („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 100/2005).
- **Kolona 3**, plotësohet yllza (*) në rast se mbeturinat janë të shënuara si të rrezikshme sipas Listës së llojeve të mbeturinave.
- **Kolona 4**, plotësohet emri i plotë i mbeturinave nga Lista e llojeve të mbeturinave.
- **Kolona 5**, plotësohen të dhëna për prejardhjen e mbeturinave të pranuar (titulli/emri dhe adresa e krijuesve, mbledhësve të tjerë dhe instalacioneve, Institucioneve administrative dhe publike). Nëse mbeturinat janë të importuara, atëherë plotësohen të dhënat themelore për instalacionin (emri/adresa) dhe emri i shtetit nga i cili kanë prejardhje ato mbeturina.
Për mbeturinat komunale të mbledhura nga qytetarët plotësohet fjala „amvisëri“.
Për mbeturinat komerciale plotësohen të dhëna (titulli/emri) për personat juridik dhe fizik me të cilët është lidhur kontratë për mbledhjen/transportimin e mbeturinave.
- **Kolona 6 dhe 7**, plotësohen sasia e mbeturinave në tonelata ose metër kub (t, m³).
- **Kolona 8**, plotësohen të dhëna për veprimet të cilat do të kryen me plotësimin e shenjës „R“ dhe numri përkatës i veprimit të përcaktuar në Nenin 29 të Ligjit për menaxhim me mbeturinat, gjegjësisht plotësohet shenja „D“ dhe numri përkatës i veprimit nga Neni 35 i po të njëjtit ligj.

Në rast se bëhet trajtimi i mbeturinave plotësohet shenja „T“. Përshkrimi i trajtimit të planifikuar plotësohet në Tabelën 4 (Kolona 5), emri i plotë i mbeturinave (Kolona 4), shifra përkatëse e mbeturinave (Kolona 2) dhe sasia e mbeturinave të trajtuara (Kolona 6). Në Kolonën 7 nga Tabela 4 plotësohet Sasia e mbeturinave në tonelata ose metër kub (t, m³).

Për rastet e tjera Kolona 8 nuk plotësohet, por si Shënim plotësohen aktivitetet e planifikuara (për sh. Për transport).





Në Tabelën 2, plotësohen të dhëna për mbeturinat e krijuara në instalacionet sipas udhëzuesit të dhënë në Tabelën 1, ashtu që:

- **Kolona 5**, plotësohen të dhëna për prejardhjen e mbeturinave të krijuara (instalacion/ faza e procesit nga i cili prodhohen mbeturinat).
- **Kolona 6 dhe 7**, plotësohen sasi të përgjithshme të deponuara nga vetë krijuesi, gjegjësisht koha e magazinimit të mbeturinave. Këto kolona plotësohen vetëm nëse aplikohen veprime të tilla mbi mbeturinat.
- **Kolona 8**, plotësohen të dhëna sipas udhëzimit të dhënë në Tabelën 1 Kolona 8.

Në rastet kur krijohet sasi e vogël e mbeturinave, kjo sasi nuk matet menjëherë. Kjo gjendje evidentohet si Shënim me vërejtje se sasia e mbeturinave do të përcaktohet kur ato të maten dhe të dorëzohen tek persona të tjerë.

Tabelara 3, plotësohen të dhënat sipas udhëzuesit të dhënë për Tabelën 1, ashtu që:

- **Kolona 5**, plotësohen të dhëna për titullin dhe adresën e personave juridik dhe fizik të cilëve ju dorëzohen mbeturinat. Nëse mbeturinat eksportohen, atëherë plotësohen të dhëna për instalacionin (titulli dhe adresa) dhe emri i shtetit në të cilin eksportohen mbeturinat.
- **Kolona 6 dhe 7**, plotësohen sasi të përgjithshme të mbeturinave të dorëzuara, gjegjësisht mbeturinave të eksportuara në tonelata ose metër kub (t, m³).
- **Kolona 8**, plotësohen të dhëna sipas udhëzimit të dhënë në Tabelën 1 Kolona 8.

Personi përgjegjës i vërteton të dhënat ditore të plotësuara me firmën dhe vulën e tij.





Shtojca 2

FORMULAR IDENTIFIKUES PËR MBETURINA

1. TË DHËNA PËR POSEDUESIN E MBETURINAVE	
1.1 Titulli/emri i poseduesit:	
1.2 Numri i lejes:	Numri i lejes IPPC:
1.3 Adresa/Vendi:	
1.4 Vendi i mbeturinave:	
2. TË DHËNA PËR PERSONIN PËRGJEGJËS	
2.1 Emri dhe mbiemri:	
2.2 Telefoni/faksi:	
2.3 E-mail:	
3. TË DHËNA PËR MBETURINAT	
3.1 Përshkrim i mbeturinave:	
3.2 Shifra e mbeturinave.....	<input type="text"/> <input type="text"/> <input type="text"/> <input type="text"/> <input type="text"/> <input type="text"/>
3.3 H - shifra: ...	<input type="text"/> <input type="text"/> <input type="text"/>
3.4 Mënyra e paketimit të mbeturinave:	
3.5 Sasia e përgjithshme e mbeturinave të cilat duhet të identifikohen : _____ (t, m ³)	
3.6 Instalimi/faza e procesit nga i cili rrjedhin mbeturinat:	
3.7 Lloji i transportit:	
4. VEPRIMET E PLANIFIKUARA ME MBETURINAT TË CILAT DUHET TË IDENTIFIKOHEN	
a)	
b)	
c)	

Në _____

Personi përgjegjës:

Data _____





UDHËZUES PËR PLOTËSIMIN E FORMULARIT IDENTIFIKUES PËR MBETURINA

1. Të dhëna për poseduesin e mbeturinave

- 1.1. Plotësohet titulli/emri i personit juridik ose fizik, posedues i mbeturinave të cilat dorëzohen për transport.
- 1.2. Plotësohet numri i lejes (licencës) së marrë në përputhje me Ligjin për menaxhimin me mbeturinat dhe numrin e lejes së integruar ekologjike të marrë në përputhje me Ligjin për ambientin jetësor („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 53/2005), nëse mund të aplikohet.
- 1.3. Plotësohet adresa /adresa e ndërmarrjes.
- 1.4. Plotësohet adresa dhe/ose vendi ku krijohen dhe/ose vendi ku ndodhen mbeturinat.

2. Të dhëna për personin përgjegjës

- 2.1. Plotësohet emri dhe mbiemri.
- 2.2. Plotësohet numri i telefoni/faksi.
- 2.3. Plotësohet adresa elektronike (nëse ka).

3. Të dhëna për mbeturinat

- 3.1. Plotësohet emri i plotë i mbeturinave nga Lista e llojeve të mbeturinave me përshkrim të përbërësve të tyre.
- 3.2. Plotësohet shifra gjashtëshifërshe e mbeturinave nga Lista e llojeve të mbeturinave.
- 3.3. Për mbeturinat e rrezikshme kjo pjesë plotësohet sipas Listës së karakteristikave të rrezikshme të mbeturinave nga Ligji për ratifikimin e konventës së Bazelit për nxjerrjen e mbeturinave të rrezikshme jashtë kufijve dhe për mënjanimin e tyre. („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.49/97).
- 3.4. Shënohet mënyra e paketimit (në enë deri në 1 m³, thasë plasmasi, kontejnerë, cisterna, ndërsa llojet e tjera të paketimit duhet të precizohen).
- 3.5. Shënohet sasia e përgjithshme e mbeturinave të cilat identifikohen në tonelata ose në metër kub (t, m³).
- 3.6. Plotësohet emri i instalacionit/fazës së procesit nga e cila rrjedhin mbeturinat.
- 3.7. Shënohet lloji i transportit.(rrugor, hekurudhor etj.)





4. Veprimet e planifikuara me mbeturinat të cilat identifikohen

Në këtë rubrikë plotësohen të dhëna përshkuese për veprimet e planifikuara me mbeturinat „R“, „D“, gjegjësisht lloji i trajtimit të mbeturinave si dhe masa të tjera të planifikuara.

Personi përgjegjës i vërteton të dhënat e plotësuara me firmë dhe me vulë.

Shënim:

Formulari identifikues jipet gjatë transportit të mbeturinave industriale të rrezikshme dhe jo të rrezikshme.

Formulari identifikues i shoqëron mbeturinat që nga fillimi deri në destinacionin final dhe përpilohet në 5 kopje.

Originalin (fleta nr. 1) poseduesi e dorëzon tek organi përgjegjës (në përputhje me Nenin 56 paragrafi 4 dhe 61, paragrafi 4 i Ligjit për menaxhim me mbeturinat), ndërsa kopjen e parë (fleta nr. 2) me firmë të mbledhësit /transportuesit e mban për vete.

Kopjen e dytë (fleta nr.3) e mban mbledhësi/transportuesi pas firmosjes nga ana e poseduesit final.

Kopjen e tretë (fleta nr. 4) poseduesi final e mban për vete, ndërsa kopjen e katërt (fleta nr.5) ia këthen poseduesit i cili i ka dorëzuar mbeturinat për transport.





Shtojca 3

FORMULARI PËR TRANSPORTIN E MBETURINAVE

1. Lloji i mbeturinave: _____	
2. Shifra e mbeturinave <input type="text"/> <input type="text"/> <input type="text"/> <input type="text"/> <input type="text"/> <input type="text"/>	3. Sasia e mbeturinave _____ (t, m ³)
4. Posedues: _____ Adresa: _____ Sasia e përgjithshme e mbeturinave të dorëzuara/transportues: _____ (t, m ³) Në _____ Personi përgjegjës: Data e dorëzimit: _____	
5. Mbledhës/Transportues: _____ Adresa: _____ Numri i lejes: _____ Sasia e përgjithshme e mbeturinave të pranuar: _____ (t, m ³) Në _____ Firma: _____ Data e dorëzimit: _____	
6. Poseduesi final i mbeturinave: _____ Adresa: _____ Sasia e përgjithshme e mbeturinave të pranuar: _____ (t, m ³) Në _____ Personi përgjegjës: Data e dorëzimit: _____	





7. Destinacioni fillestar dhe i fundit i mbeturinave:

Shënim:





UDHËZUES PËR PLOTËSIMIN E FORMULARIT TRANSPORTUES TË MBETURINAVE

1. Plotësohet emri i plotë i mbeturinave nga Lista e llojeve të mbeturinave.
2. Plotësohet shifra gjashtëshifrore e mbeturinave od Lista e llojeve të mbeturinave.
3. Plotësohet sasia e mbeturinave në tonelata ose metër kub (t, m³).
4. Plotësohet titulli/emri i personit juridik dhe fizik, poseduesit të mbeturinave i cili ka dorëzuar mbeturinat për transport.
Gjithashtu, plotësohet adresa dhe sasia e përgjithshme e mbeturinave të dorëzuara në tonelata ose metër kub (t, m³), vendi dhe data e dorëzimit të mbeturinave, firma e personit përgjegjës dhe vula.
5. Plotësohet titulli/emri i mbledhësit/transportuesit (personi juridik ose fizik), adresa dhe numri i lejes (licencës) së fituar në pajtim me Ligjin për menaxhim me mbeturinat. Gjithashtu, plotësohet sasi e përgjithshme e mbeturinave të pranuar në tonelata ose në metër kub (t, m³), vendi dhe data e dorëzimit dhe firma e personit i cili i pranon mbeturinat.
Në rast se mbledhësi dhe transportuesi janë persona juridik ose fizik të ndryshëm ose nëse bëhet fjalë për transportues të ndryshëm, atëherë të dhënat për transportuesin jipen si shtojcë dhe plotësohen si shënim „shiko shënimin“.
6. Plotësohet titulli/emri i personit juridik dhe fizik, poseduesi final i mbeturinave, adresa dhe data e pranimit të mbeturinave mbeturinat, firma dhe vula e personit përgjegjës.
7. Në rubrikën 7, poseduesi i mbeturinave nga rubrika 4 plotëson të dhëna për destinacionin fillestar dhe final të mbeturinave.

Shënim:

Formulari i transportit i shoqëron mbeturinat nda destinacioni fillestar deri në atë final dhe jipet në 5 kopje.

Origjinalin (fleta nr. 1) poseduesi i mbeturinave nga rubrika 4 e dorëzon tek organi kompetent i komunave dhe qytetit të Shkupit (për mbeturina komunale dhe për mbeturina të tjera jo të rrezikshme), për mbeturina të rrezikshme tek Shërbimi për ambientin jetësor pranë Ministrisë të ambientit jetësor dhe planifikimit hapsinor, ndërsa kopjen e parë (fleta nr. 2), me firmë të mbledhësit/transportuesit e ruan për vete.

Kopjen e dytë (fleta nr.3) me firmë të poseduesit final e mban mbledhësi/transportuesi.

Kopjen e tretë (fleta nr. 4) me firmë të mbledhësit/transportuesit, e mban Poseduesi final ndërsa, kopjen e katërt (fleta nr.5) me firmë të mbledhësit/transportuesit dhe firmë personale ia këthen poseduesit i cili i ka dorëzuar mbeturinat për transport.





Shtojca 4

RAPORTI VJETOR PËR MANIPULIMIN ME MBETURINAT NGA PERSONAT JURIDIK DHE FIZIK

1. TË DHËNA PËR POSEDUESIN E MBETURINAVE □□□□□□- Viti
1.1 Titulli/emri I POSEDUESIT 1.2 Numri i lejes: Numri i lejes IPPC: 1.3 Adresa/Vendi: 1.4 Shifra e veprimtarisë:
2. PERSONI PËRGJEGJËS
2.1 Emri dhe mbiemri: 2.2 Telefoni/faksi: 2.3 E-mail:

Personi përgjegjës

Personi i autorizuar

Data: _____

Vendi _____





Tabela 1 - Mbeturina të pranuar nga persona të tjerë

Nr. Rendor	Shifra	Përsh. i mbeturinave	Lloji i mbeturinave	Prejardhja e mbeturinave të pranuar	Sasia e mbeturinave të pranuar		Sasia e mbeturinave nga importi		Manipulime të mëtejshme
					t	m ³	t	m ³	
1	2	3	4	5	6		7		8

Data: _____

Personi përgjegjës: _____

Vendi: _____

Tabela 2 - Mbeturina të krijuara

Nr. Rendor	Shifra	Përsh. i mbeturinave	Lloji i mbeturinave	Prejardhja e mbeturinave të krijuara	Manipulime me mbeturinat					
					Deponim personal		Magazininim i përkohshëm		Manipulime të mëtejshme	
					t	m ³	t	m ³	t	m ³
1	2	3	4	5	6		7		8	

Data: _____

Personi përgjegjës: _____

Vendi: _____

Tabela 3 - Mbeturina të dorëzuara te persona të tjerë

Nr. Rendor	Shifra	Përsh. i mbeturinave	Lloji i mbeturinave	Subjekti të cilit i janë dorëzuar mbeturinat	Sasia e mbeturinave të dorëzuara		Sasia e mbeturinave të eksportuara		Manipulime të mëtejshme
					t	m ³	t	m ³	
1	2	3	4	5	6		7		8

Data: _____

Personi përgjegjës: _____

Vendi: _____





Tabela 3 - Të dhëna për trajtimet

Nr. Rendor	Shifra	Përsh. i mbeturinave	Lloji i mbeturinave	Përshkrim i trajtimit	Sasia e mbeturinave të trjtuara		Mbetje gjatë trajtimit	
					t	m ³	t	m ³
1	2	3	4	5	6		7	

Data: _____

Personi përgjegjës: _____

Vendi: _____

UDHËZUES PËR PLOTËSIMIN E RAPORTIT VJETOR PËR MANIPULIMIN ME MBETURINAT NGA PERSONAT JURIDIK DHE FIZIK

1. Të dhëna për poseduesin e mbeturinave

Në këtë rubrikë plotësohet viti për të cilin dorëzohet raporti.

- 1.1. Plotësohet titulli/emri, njësia organizative/sektori i personit juridik dhe fizik, posedues i mbeturinave.
- 1.2. Plotësohet numri i lejes (licenca) e fituar në pajtim me Ligjin për menaxhimin me mbeturinat dhe numri i lejes së integruar ekologjike të fituar në pajtim me Ligjin për ambientin jetësor, në rast së është mund të aplikohet.
- 1.3. Plotësohet adresa e personit juridik dhe fizik.
- 1.4. Plotësohet shifra e veprimtarisë së personit juridik dhe fizik.

2. Të dhëna za personi përgjegjës

- 2.1. Plotësohet Emri dhe mbiemri.
- 2.2. Plotësohet numri numri i telefonit/telefaks.
- 2.3. Plotësohet adresa elektronike, nëse ka.

Personi përgjegjës dhe personi i autorizuar i vërtetojnë të dhënat e plotësuara me firma dhe vulë.

Tabela 1, plotësohen të dhënat për sasinë e përgjithshme të mbeturinave të pranuar nga persona juridik dhe fizik të tjerë në vit, ashtu që:

- **Kolona 1**, plotësohet numri rendor për secilin lloj të mbeturinave si shifër e parë dhe numri në Tabelë si shifër e dytë (sh. 1/1, 2/1, 3/1 etj).
- **Kolona 2**, për secilin lloj të mbeturinave plotësohet shifra gjashtëshifrore nga Lista e llojeve të mbeturinave.





- **Kolona 3**, plotësohet yllzë (*) nëse mbeturinat janë të shënuara si mbeturina të rrezikshme në Listën e llojeve të mbeturinave.
- **Kolona 4**, plotësohet emri i plotëполното i mbeturinave nga Lista e llojeve të mbeturinave.
- **Kolona 5**, plotësohen të dhëna për prejardhjen e mbeturinave të pranuar (titulli/emri dhe adresa e krijuesve, mbledhësve të tjerë dhe instalacioneve, Institucioneve administrative dhe publike). Nëse mbeturinat janë të importuara, atëherë plotësohen të dhënat themelore për instalacionin (emri/adresa) dhe emri i shtetit nga i cili kanë prejardhje ato mbeturina.

Për mbeturinat komunale të mbledhura nga qytetarët plotësohet fjala “amvisëri”.

Për mbeturinat komerciale plotësohen të dhëna (titulli/emri) për personat juridik dhe fizik me të cilët është lidhur kontratë për mbledhjen/transportimin e mbeturinave.

- **Kolona 6 dhe 7**, plotësohen sasi të e mbeturinave në tonelata ose metër kub (t, m³).
- **Kolona 8**, plotësohen të dhëna për veprimet të cilat do të aplikohen gjatë manipulimit me mbeturinat me plotësimin e shenjës „R” dhe numri përkatës i veprimit të përcaktuar në Nenin 29 të Ligjit për menaxhim me mbeturinat, gjegjësisht plotësohet shenja „D” dhe numri përkatës i veprimit nga Neni 35 i po të njëjtit ligj.

Në rast se bëhet trajtimi i mbeturinave plotësohet shenja „T”.

Përshkrimi i trajtimit të planifikuar plotësohet në Tabelën 4 (Kolona 5), emri i plotë i mbeturinave (Kolona 4), shifra përkatëse e mbeturinave (Kolona 2) dhe sasia e mbeturinave të trajtuara (Kolona 6).

Në Kolonën 7 nga Tabela 4 plotësohet sasia e mbetur e mbeturinave në tonelata ose metër kub (t, m³).

Për rastet e tjera Kolonara 8 nuk plotësohet, por si Shënim plotësohen aktivitetet e planifikuara (për sh. Për transport).

Në Tabelën 2, plotësohen të dhëna për mbeturinat e krijuara në instalacionet në vit sipas udhëzuesit të dhënë në Tabelën 1, ashtu që:

- **Kolona 5**, plotësohen të dhëna për prejardhjen e mbeturinave të krijuara (instalacion/faza e procesit nga i cili prodhohen mbeturinat)
- **Kolona 6 dhe 7**, plotësohen sasi të përgjithshme të deponuara nga vetë krijuesi, gjegjësisht magazinimi i përkohshëm i mbeturinave, nëse aplikohen veprime të tilla mbi mbeturinat.
- **Kolona 8**, plotësohen të dhëna sipas udhëzimit të dhënë në Tabelën 1 Kolona 8.

Tabela 3, plotësohen të dhënat për mbeturinat e dorëzuara tek persona të tjerë juridik dhe fizik sipas udhëzuesit të dhënë për Tabelën 1, ashtu që:





- **Kolona 5**, plotësohen të dhëna për titullin dhe adresën e personave juridik dhe fizik të cilëve ju dorëzohen mbeturinat. Nëse mbeturinat eksportohen, atëherë plotësohen të dhëna për instalacionin (titulli dhe adresa) dhe emri i shtetit në të cilin eksportohen mbeturinat.
- **Kolona 6 dhe 7**, plotësohen të dhëna për sasi të përgjithshme të mbeturinave të dorëzuara, gjegjësisht mbeturinave të eksportuara në tonelata ose metër kub (t, m³).
- Kolona 8, plotësohen të dhëna sipas udhëzimit të dhënë në Tabelën 1 Kolona 8.

Personi përgjegjës i vërtetohet të dhënat ditore të plotësuara me firmën dhe vulën e tij.

Shënim:

Raportet vjetor të konsoliduar të personave juridik dhe fizik dorëzohen tek Shërbimi për ambientin jetësor pranë Ministrisë të ambientit jetësor dhe planifikimit hapsinor më së voni deri në 31 janar të vitit aktual për vitin e kaluar. Të dhënat për mbeturinat komunale dhe llojet e tjera të mbeturinave jo të rrezikshme të mbledhura dhe të transportuara dorëzohen tek organi kompetent i komunave dhe qytetit të Shkupit.

Shtojca 5

RAPORTI VJETOR PËR MANIPULIMIN ME MBETURINAT NGA KRYETARI I KOMUNËS

1. TË DHËNA PËR KOMUNËN Komuna/adresa: _____ □□□□□□- Viti
1.1 Numri i banorëve: 1.2 Adresa: 1.3 Telefoni/faksi: 1.4 E-mail:
2. PERSONI PËRGJEGJËS I ORGANIT KOMPETENT
2.1 Emri dhe mbiemri i personit përgjegjës: 2.2 Telefoni/faksi: 2.3 E-mail:

në: _____

Kryetari i komunës:

Data: _____





Numri rendor	Shifra e mbeturinave	Lloji i mbeturinave	Sasia vjetore	
			t	m ³
1	2	3	4	

Tabela 1 - Të dhëna për mbeturinat komunale dhe lloje të tjera të mbeturinave jo të rrezikshme të mbledhura dhe të transportuara.

Numri rendor	Shifra e mbeturinave	Lloji i mbeturinave	Sasia vjetore	
			t	m ³
1	2	3	4	

Tabela 2 - Të dhëna për mbeturinat komunale dhe lloje të tjera të mbeturinave jo të rrezikshme të mënjanuara

Numri rendor	Shifra e mbeturinave	Lloji i mbeturinave	Sasia vjetore	
			t	m ³
1	2	3	4	

Tabela 3 - Të dhëna për mbeturinat inerte të mënjanuara





UDHËZUES PËR PLOTËSIMIN E RAPORTIT VJETOR PËR MANIPULIMIN ME MBETURINAT NGA KRYETARI I KOMUNËS

1. Të dhëna për komunën

Në këtë rubrikë plotësohet viti për të cilin përpilohet raporti, emri i komunës dhe adresa.

- 1.1. Plotësohet numri i banorëve në komunë.
- 1.2. Plotësohet adresa e komunës.
- 1.3. Plotësohet numri i telefonit/telefaks.
- 1.4. Plotësohet adresa elektronike, nëse ka.

2. Të dhëna për personin përgjegjës të organit kompetent.

- 2.1. Plotësohet emri dhe mbiemri dhe mbiemri i personit përgjegjës të komunës.
- 2.2. Plotësohet numri i telefonit/telefaks.
- 2.3. Plotësohet adresa elektronike, nëse ka.

Kryetari i komunës i vërteton të dhënat e plotësuara me firmë dhe vulë.

Tabela 1, plotësohen të dhëna për mbeturinat komunale dhe lloje të tjera të mbeturinave jo të rrezikshme të mbledhura dhe të transportuara, ashtu që:

- **Kolona 1**, plotësohet numri rendor për secilin lloj të mbeturinave si shifër e parë dhe numri në Tabelë si shifër e dytë (sh. 1/1, 2/1, 3/1 etj)
- **Kolona 2**, për secilin lloj të mbeturinave plotësohet shifra gjashtëshifrore nga Lista e llojeve të mbeturinave,
- **Kolona 3**, Plotësohet emri i plotë i mbeturinave nga Lista e llojeve të mbeturinave,
- **Kolona 4**, plotësohen sasitë e përgjithshme vjetore të mbeturinave të mbledhura dhe të transportuara për periudhën e përfshirë në raport për cesilin lloj të mbeturinave në veçanti,

Tabela 2 dhe 3, plotësohen të dhëna për mbeturinat komunale dhe lloje të tjera të mbeturinave jo të rrezikshme si dhe mbeturinat inerte të mënjauara dhe plotësohet një lloj si edhe në Tabelën 1.

Shënim:

Raportet vjetor të konsoliduar të kryetarit të komunës dorëzohen tek Shërbimi për ambientin jetësor pranë Ministrisë të ambientit jetësor dhe planifikimit hapsinor më së voni deri në 31 janar të vitit aktual për vitin e kaluar.





Shtojca 6

DITAR PËR EVIDENTIMIM PËR MANIPULIM ME MBETURINAT PËR NË DEPONI

Emri:

Adresa:

Data:

Tabela 1 - Të dhëna për mbeturinat e pranuar komunale dhe mbeturinat e tjera të pranuar

Numri rendor	Shifra e mbeturinave	Lloji i mbeturinave	Sasia		Personi juridik/ fizik dhe komuna
			t	m ³	
1	2	3	4		5

Personi përgjegjës

Tabela 2 – Të dhëna për mbeturinat inerte të pranuar

Numri rendor	Shifra e mbeturinave	Lloji i mbeturinave	Sasia		Personi juridik/ fizik dhe komuna
			t	m ³	
1	2	3	4		5

Personi përgjegjës

Tabela 3 - Të dhëna për mbeturinat e rrezikshme të pranuar

Numri rendor	Shifra e mbeturinave	Lloji i mbeturinave	Sasia		Personi juridik/ fizik dhe komuna
			t	m ³	
1	2	3	4		5

Personi përgjegjës





Tabela 4 – Veprime ditore gjatë eksplotimit të deponisë

Sipërfaqja e përgjithshme për eksplotim për qelinë nr.	Sipërfaqja ditore e eksplotuar	Lartësia e shtresës ditore (m)	Mbulimi ditor: Lartësia (m) dhe sasia e dheut (m ³)	Mbeturina të dorëzuara për riciklim/kompostim (t)	Lloj tjetër i trajtimit të mbeturinave (t)
1	2	3	4	5	6

Personi përgjegjës





UDHËZUES PËR PLOTËSIMIN E DITARIT PËR PËR EVIDENTIMIN E MANIPULIMEVE ME MBETURINAT PËR NË DEPONI

Në nënpjesën e ditarit plotësohet emri i deponisë, adresa dhe data e plotësimit të të dhënave.

Tabela 1, 2,3 plotësohen të dhëna për mbeturinat komunale dhe lloje të tjera të mbeturinave jo të rrezikshme, inerte dhe mbeturina të rrezikshme, ashtu që:

- **Kolona 1**, plotësohet numri rendor për secilin lloj të mbeturinave si shifër e parë dhe numri në Tabelë si shifër e dytë (sh. 1/1, 2/1, 3/1 etj)
- **Kolona 2**, për secilin lloj të mbeturinave plotësohet shifra gjashtëshifrore nga Lista e llojeve të mbeturinave,
- **Kolona 3**, plotësohet emri i plotë i mbeturinave nga Lista e llojeve të mbeturinave,
- **Kolona 4**, plotësohen sasi të mbeturinave në tonelata ose metër kub, (t, m³).
- **Kolona 5**, plotësohen të dhëna për personat juridik dhe fizik, vendbanimet dhe komunat nga të cilat kanë prejardhje mbeturinat.

Tabela 4, plotësohen veprimet ditore gjatë eksploatimit të deponive, ashtu që:

- **Kolona 1**, plotësohet sipërfaqja e përgjithshme e eksploatuar në metra katrorë (m²).
- **Kolona 2**, plotësohet sipërfaqja ditore e eksploatuar në metra katrorë (m²).
- **Kolona 3**, plotësohet lartësia e shtresës ditore në metra (m).
- **Kolona 4**, plotësohet lartësia e dheut të përdorur për mbulimin e mbeturinave në metra (m) dhe sasia e tij në metra kub (m³).
- **Kolona 5**, plotësohet sasia e mbeturinave të dorëzuara për riciklim ose kompostim në tonelata (t).
- **Kolona 6**, plotësohen të dhëna për lloje të tjera të trajtimit të mbeturinave në tonelata (t) nëse ka.

Personi përgjegjës i vërteton të dhënat e plotësuara me firmë dhe vulë.





Shtojca 7

RAPORTI VJETOR PËR MANIPULIMIN E MBETURINAVE PËR NË DEPONI

1. TË DHËNA PËR DEPONINË

□□□□□- Viti

- 1.1 Emri i deponisë:
- 1.2 Vendi:
- 1.3 Komuna:
- 1.4 Klasa e deponisë:
- 1.5 Numri i lejes: Numri i lejes IPPC:
- 1.6 Shifra e veprimtarisë:
- 1.7 Sasia e përgjithshme me mbeturinave të deponuara deri në plotësimin e këtij formulari (t, m³):

2. PERSONI PËRGJEGJËS

- 2.1 Emri dhe mbiemri:
- 2.2 Telefoni/faksi:
- 2.3 E-mail:

Personi përgjegjës
Personi i autorizuar

Data: _____

Vendi: _____





Tabela 1 - Të dhëna për rajonet e përfshira në shërbim

Numri rendor	Vendi/komuna	Numri banorëve të shërbyer	Persona juridik dhe fizik
1	2	3	4

Tabela 2 - Të dhëna për mbeturinat komunale të pranuar dhe llojet e tjera të mbeturinave jo të rrezikshme

Numri rendor	Shifra e mbeturinave	Lloji i mbeturinave	Sasia	
			t	m ³
1	2	3	4	

Tabela 3 - Të dhëna për mbeturinat inerte të pranuar

Numri rendor	Shifra e mbeturinave	Lloji i mbeturinave	Sasia	
			t	m ³
1	2	3	4	

Tabela 4 - Të dhëna për mbeturinat e rrezikshme të pranuar

Numri rendor	Shifra e mbeturinave	Lloji i mbeturinave	Sasia	
			t	m ³
1	2	3	4	





Tabela 5 – Veprime gjatë eksploatimit të deponisë

Sipërfaqja e përgjithshme për eksploatim (m ²)	Numri dhe shenja e qelive	Sipërfaqja vjetore e eksploatuar (m ²)	Numri i shtresave	Sasia e tokës që mbulohet (m ³)	Shkalla e kompaktimit (t/m ³)
1	2	3	4	5	6





Tabela 6. Të dhëna të tjera për deponinë

1. Përqindja e komponentëve biologjikisht të tretshme në mbeturinat komunale: _____ %

2. Monitorimi i:

- Ujërave nëntokësorë :
- Filtrat
- Ujërave sipërfaqësorë
- Gjendja e deponisë

3. Paraqitje e dëmtimit

Përshkrimi dëmtimit:

Veprime të ndërmarra:

Pasoja nga dëmtimi:





UDHËZUES PËR PLOTËSIMIN E RAPORTIT VJETOR PËR MANIPULIMIN E MBETURINAVE PËR NË DEPONI

1. Të dhëna për deponinë

Në këtë rubrikë plotësohet viti për të cilin dorëzohet raporti vjetor për deponitë .

- 1.1. Plotësohet emri i instalacionit për mënjanimin e mbeturinave/deponisë,
- 1.2. Plotësohet emri i vendbanimit,
- 1.3. Plotësohet emri i komunës,
- 1.4. Plotësohet kategoria e deponisë, nëse aplikohet,
- 1.5. Plotësohen numri i lejes të marrë në pajtim me Ligjin për menaxhim me mbeturinat dhe numri i lejes së integruar ekologjike në pajtim me Ligjin për ambientin jetësor, nëse aplikohet,
- 1.6. Plotësohet shifra e veprimtarisë,
- 1.7. Plotësohet sasia e përgjithshme e mbeturinave të deponuara në tonelata ose metër kub (t, m³).

Personi i autorizuar dhe përgjegjës i instalacionit/deponisë i vërteton të dhënat e plotësuara me firmë dhe me vulë.

2. Të dhëna për personin përgjegjës

- 2.1. Plotësohet emri dhe mbiemri,
- 2.2. Plotësohet numri i telefonit/telefaksit,
- 2.3. Plotësohet adresa elektronike, nëse ka.

Tabela 1, plotësohen të dhëna për rajonet e mbuluara në nivel vjetor, ashtu që:

- **Kolona 1**, plotësohet numri rendor i rajonit të mbuluar,
- **Kolona 2**, plotësohet emri i vendbanimit/komunës,
- **Kolona 3**, plotësohet numri i banorëve të shërbyer,
- **Kolona 4**, plotësohet titulli/emri i personit juridik/fizik të shërbyer.

Tabela 2 dhe 3, plotësohen të dhëna për sasi të pranuar të mbeturinave komunale dhe lloje të tjera të mbeturinave jo të rrezikshme, mbeturinave inerte dhe mbeturinave të rrezikshme në vit, ashtu që:

- **Kolona 1**, plotësohet numri rendor për secilin lloj të mbeturinave si shifër e parë dhe numri në Tabelë si shifër e dytë (sh. 1/1, 2/1, 3/1 etj)
- **Kolona 2**, për secilin lloj të mbeturinave plotësohet shifra gjashtëshifrore nga Lista e llojeve të mbeturinave,





- **Kolona 3**, plotësohet emri i plotë i mbeturinave nga Lista e llojeve të mbeturinave,
- **Kolona 4**, plotësohen sasi të mbeturinave në tonelata ose metër kub, (t, m³).

Tabela 5, plotësohen veprimet gjatë eksploatimit të deponive, ashtu që në:

- **Kolona 1**, plotësohet sipërfaqja e përgjithshme e deponisë në metra katrorë (m²) paraparë sipas projektit kryesor,
- **Kolona 2**, plotësohet numri dhe shenja e qelive të eksploatuara gjatë një viti,
- **Kolona 3**, plotësohet sipërfaqja e eksploatuar gjatë një viti në metra katrorë (m²),
- **Kolona 4**, plotësohet numri i shtrësave të mbeturinave,
- **Kolona 5**, plotësohet sasia e dheut e përdorur për mbulimin e mbeturinave në metra kub (m³),
- **Kolona 6**, plotësohet shkalla e kompaktimit (t/m³).

Tabela 6, plotësohen të dhëna të tjera, gjegjësisht:

- (1), përcaktohet përqindja e mbeturinave biologjike të tretshme përmes përcaktimit të përmbajtjes së mbeturinave
- (2), evidentohet lloji i monitorimit i cili bëhet me plotësimin e shenjës „x“ në katrorin përkatës,
- (3), plotësohen me përshkrim të dhënat për havarinë, llojet e masave të ndërmarra dhe vlerësimi i pasojave të të njëjtës

Shënim:

Raportet vjetor të konsoliduar për deponitë dorëzohen tek organi kompetent i konunës për mbeturina komunale dhe lloje të tjera të mbeturinave jo të rrezikshme dhe mbeturina inerte më së voni deri në 31 mars të vitit aktual për vitin e kaluar, ndërsa për mbeturinat e rrezikshme dorëzohet tek Shërbimi për ambientin jetësor pranë Ministrisë të ambientit jetësor dhe planifikimit hapsinor.





Shtojca nr.3

Për mënyrat e manipulimit me mbeturinat mjekësore, si dhe mënyrat e paketimit dhe shënimit të mbeturinave mjekësore, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.146/07.

Në bazë të Nenit 73 paragrafi 5 nga Ligji për menaxhimin me mbeturinat ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.68/04 dhe 71/04 dhe 107/07), Ministri i ambientit jetësor dhe planifikimit hapsinor në pajtim me Ministrin e shëndetësisë dhe Ministrin e bujqësisë, pyjeve dhe administrimit të ujërave miratoi

RREGULLORE

Për mënyrat e manipulimit me mbeturinat mjekësore, si dhe mënyrat e paketimit dhe shënimit të mbeturinave mjekësore

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Lënda e rregullimit

1.Me këtë rregullore përcaktohet mënyra e manipulimit me mbeturinat mjekësore, si dhe mënyrat e paketimit dhe shënimit të mbeturinave mjekësore të cilat krijohen në institucionet mjekësore dhe shëndetësore (stacionarë, spitale, poliklinika dhe ambulanta, ordianca stomatologjike, ordianca të cilat ofrojnë shërbime të caktuara shëndetësore, laboratorë kërkimorë – institute veterinarë etj.) nga instrumentat dhe materialet që përdoren për diagnostifikim, shërim, trajtim dhe parandalim të sëmundjeve tek njeriu dhe kafshët.

Mbeturinat mjekësore nga paragrafi 1 i këtij Neni mund të jenë të rrezikshme nëse përmbanë një nga karakteristikat e përcaktuara në Nenin 6 paragrafi 1 pika 2 e Ligjit për menaxhimin me mbeturinat.

Neni 2

Definicione

Shprehje të veçanta të përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:

1. Mbeturina mjekësore janë mbeturinat të cilat krijohen në institucionet mjekësore dhe shëndetësore (stacionarë, spitale, poliklinika dhe ambulanta, ordianca stomatologjike,





- ordinanca të cilat ofrojnë shërbime të caktuara shëndetësore, laboratorë kërkimorë – institute veterinare etj. nga mjetet dhe materialet që përdoren për diagnostifikim, shërim, trajtim dhe parandalim të sëmundjeve tek njeriu dhe kafshët.
2. Mbeturinat patologjike (anatomike) janë mbeturina të cilat përmbajnë pjesë të trupit të njeriut- amputante, inde, dhe organe të nxjerra gjatë ndërhyrjeve kirurgjikale, inde të marra për qëllime diagnostikimi, placenta, fetuse, kafshë dhe pjesë të tyre.
 3. Mbeturina infektive janë mbeturinat të cilat përmbajnë agjensë biologjik patogjenë të cilët për shkak të llojit të tyre, përqëndrimit ose sasisë mund të shkaktojnë sëmundje tek njerëzit e ekspozuar, kultura dhe pajisje nga laboratorë mikrobiologjik, pjesë të pajisjeve, materiale dhe pajisje të cilat kanë ardhur në kontakt me gjak ose tajitje të tjera të personave të sëmurë nga sëmundje infektive ose që janë përdorur gjatë ndërhyrjes kirurgjikale, izolimi i të sëmurëve, meturina nga repartet e dializës, sistemeve për infuzion, doreza dhe pajisje të tjera për një përdorim, mbeturina të cilat kanë ardhur në kontakt me kafshë eksperimental tek të cilat është inokuluar materiali infektiv.
 4. Mbeturina nga mjete të mprehta janë mbeturinat të cilat përmbajnë gjilpëra, lanceta, skalpelë dhe mjete të tjera të mprehta të cilat mund të shpojnë ose presin, gjegjësisht mbledhja dhe mënjanimi të cilëve është lëndë e kërkesave të posaçme për shkak të mbrojtjes nga infektionet.
Mbeturinat nga mjetet e mprehta, qoftë të kontaminuara ose të pakontaminuara duhet të konsiderohen si nëngrup i mbeturinave infektive.
 5. Mbeturinat farmaceutike janë mbeturina të cilat janë të përbërë ose përmbajnë prodhime farmaceutike, barna citostatike dhe citostatikë dhe barna të tjerë të cilët janë të këthyer nga reparti në të cilin ato janë derdhur, shpërndarë, avulluar, përgatitur por që nuk janë përdorur, u ka kaluar afati i përdorimit ose që duhet të hidhen për shkak të mospërdorimit të tyre për arsye të tjera, kontejnerë dhe/ose paketime, jete të kontaminuara nga ose që përmbajnë lëndë farmaceutike (shishe, kuti).
 6. Mbeturina kimike janë mbeturinat të cilat përbëhen dhe/ose përmbajnë kimikalie të mbetura të ngurta, të lëngëta ose të gazta të cilat përdoren gjatë veprimeve mjekësore, diagnostike dhe eksperimentale, për pastrim dhe dezinfektim.
 7. Mbeturina nga enë me presion të përziera me antibiotikë janë mbeturina nga enë të përdorura të cilat përmbajnë gazra inerte në presion të përziera me antibiotikë, dezinfektues, insekticide të cilat përdoren në forma të aerosoleve, ndërsa në temperatura më të larta mund të eksplodojnë.





8. Metalet e rënda janë metale të cilat përbëhen nga materjale dhe pajisje nga metalet e rënda dhe derivatet e tyre, si psh. bateritë, termometrat, manometrat etj.
9. Pika mbledhëse lokale (depo) është vendi i caktuar në nivel të njësisë ose repartit në të cilin krijohen mbeturina mjekësore.

Neni 3

Manipulimi me mbeturinat mjekësore

Manipulimi me mbeturina mjekësore përfshin aktivitete të cilat kanë të bëjnë me selekcionimin e tyre në vendin e krijimit, mbledhjen, trajtimin, përpunimin, transportin dhe mënjanimin.

Neni 4

III. Selektionimi, identifikimi, mbledhja, paketimi dhe shënimi

Mbeturinat mjekësore selekcionohen, identifikohen dhe mblidhen në paketime të përshtatura sipas karakteristikave të tyre (infektiv, që ndizet lehtë, eksploziv etj.) sipas llojit të vendit në të cilin ato krijohen, sasive, mënyrës së magazinimit, transportimit dhe mënjanimin.

(2) Paketimet mund të jenë thasë, kuti kartoni, enë të posaçme dhe kontejnerë të punuar në atë mënyrë që me karakteristikat e tyre (ngjyrë, formë, madhësi dhe përbërje) të mundësojnë dhe të lehtësojnë selekcionimin e mbeturinave sipas llojeve në vendin e krijimit të tyre dhe të sigurojnë një mbrojtje të plotë të shëndetit të njerëzve dhe ambientit jetësor.

(3) Mbeturinat e lëngëta mblidhen në paketime të papërshkueshme të cilat nuk lejojnë derdhjen ose lëshimin e përmbajtjes, prandaj duhet të jenë të mbyllura mirë ose të vulosura.

(4) Enët për gjësendet e ngurta duhet të jenë të padepërtueshme për përmbajtjen në to në kushte normale të manipulimit, të jenë të prodhuara në atë mënyrë që nuk do lejojnë dalje, derdhje të përmbajtjes ose dëmtim ose përcjellje të infektionit tek personat të cilët i përdorin ato enë ose manipulojnë me mbeturinat.

(5) Enët ose kontejnerët në të cilët mblidhen mbeturinat nga mjetet e mprehta duhet të jenë të prodhuara nga plasmasi me dendësi të madhe ose nga metali dhe të kenë kapak.

(6) Paketimet të cilat përdoren më shumë se një herë janë enë nga metali ose plasmasi të cilat mundësojnë një larje dhe dezinfektim adekuat.

(7) Gjatë selekcionimit të mbeturinave sipas llojit duhet të merret parasysh edhe kjo:

- mbeturinat infektive duhet të paketohen në qese të cilat do jenë të përshtatshme me procesin e rekomanduar të trajtimit ose mënjanimin;
- mbeturinat farmaceutike me afat të skaduar të magazinuara në reparte spitalore duhet të këthehen në barnatoret e spitalore me qëllim që pastaj të bëhet mënjanimi i tyre;
- mbeturinat e tjera farmaceutike të krijuara në repartet spitalore si barna të dredhura





- ose të konaminuara të cilët përmbajnë mbetje të barnave, nuk duhet të këthehen në barnatoret spitalore për shkak të rrezikut nga kontaminimi;
- mbeturinat kimike duhet të paktohen në kontejnerë rezistues ndaj kimikalieve;
 - mbeturinat kimike të llojeve të ndryshme nuk duhet të përzihen;
 - mbeturinat kimike të rrezikshme duhet të paktohen në paketime të cilat janë të përshtatura mënyrës së trajtimit dhe /ose mënjanimi;
 - mbeturinat të cilat përmbajnë përqindje të madhe të metaleve të rënda (sh. Kadmium dhe zhirë) duhet të mblidhen veçmas;
 - mbeturinat nga mjetet e mprehta duhet të mblidhen sëbashku, pa dallim se janë të kontaminuara apo jo.

(8) Në vendin e selekcionimit të mbeturinave mjekësore duhet të vendosen udhëzime me shkrim për personat përgjegjës të cilët i selekcionojnë, identifikojnë dhe mblidhin mbeturinat.

Neni 5

(1) Mbeturinat mjekësore paktohen në paketime të cilat janë:

- me ngjyrë të kuqe për mbeturina patologjike (anatomike);
- me ngjyrë të verdhë për mbeturinat e tjera mjekësore të rrezikshme;
- me ngjyrë të gjelbër për mbeturinat farmaceutike dhe
- me ngjyrë të kaltër ose të zezë për mbeturinat inerte ose komunale.

(2) Paketimet e mbeturinave mjekësore duhet të jenë të shënuara sipas rregullores.

(3) Në paketimet për mbeturinat mjekësore të rrezikshme nga Neni 2 pika 2, 3, 4 dhe 5 të kësaj rregulloreje (patologjike, infektive, mbeturinave nga mjetet e mprehta dhe mbeturinave farmaceutike) etiketa vendoset në vend i cili lehtë vihet re.

(4) Etiketa është me ngjyrë portokalli me dimensione 7 x 9 cm dhe përmban shenjë për mbeturina mjekësore të rrezikshme me ngjyrë të zezë me dimensione 7 x 7 cm.

(5) Nën shenjë qëndron mbishkrimi „Mbeturina mjekësore të rrezikshme” në gjuhën maqedonase dhe angleze.

(6) Në paketimet për mbeturinat mjekësore të rrezikshme nga Neni 2 pika 6 (mbeturina kimike) i kësaj rregulloreje vendoset etiketë në varësi nga vetitë sipas të cilave mbeturinat karakterizohen si të rrezikshme në pajtim me dispozitat për menaxhimin me mbeturinat e rrezikshme.

(7) Përmbajtja e etiketës nga paragrafi 4 i këtij Neni është dhënë në vazhdim dhe është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.





Neni 6

Paketimet e mbeturinave patologjike dhe mbeturinave të tjera mjekësore duhet të jenë të vendosura në mbajtëse adekuat që do mundësojnë mbledhjen e tyre sa më të sigurt.

Paketimet duhet të mbushen më së shumti deri te 2/3 e vëllimit maksimal të tyre, e pastaj të mbyllen ose të vulosen.

(3) Qeset me vëllim më të vogël mund të mbyllen me lidhje, por ato me vëllim më të madh mbyllen me plomba plasmasi të cilat mbyllen vetë.

(4) Enët e vulosura ose kontejnerët për mjete të mprehta duhet të vendosen në qese për mbeturina me ngjyrë të verdhë e të shënuara.

(5) Paketime të zbrazëta për seleksionim, identifikim dhe mbledhje të mbeturinave duhet të ketë në dispozicion vazhdimisht në të gjitha vendet në të cilat krijohen mbeturinat.

Neni 7

IV. Transporti i mbrendshëm

(1) Paketimet e shënuara dhe të mbyllura përcillen nga pika mbledhëse lokale , një herë në ditë, e sipas mundësive një herë gjatë turnit nga ana e personit përgjegjës.

(2) Mbeturinat patologjike mblidhen dhe magazinohen veçmas.

(3) Mbeturinat farmaceutike magazinohen në ambiente të posaçme (depo)

(4) Mbeturinat nga barnat citostatike duhet të ruhen të ndara nga mbeturinat e tjera mjekësore në ambient të caktuar e të sigurt.

(5) Pikat mbledhëse lokale duhet të jenë të ajrosura mirë ose të jenë në afërsi të njësisë ose repartit ku mund të mbahen temperatura të ulta me ndihmën e një sistemi ftohës i cili duhet të mbajë temperaturë nën 100°C.

Sistemi ftohës duhet të mbajë temperaturë nën 100°C .

Neni 8

(1) Transporti i mbeturinave nga pika mbledhëse lokale deri te pika mbledhëse qendrore bëhet një herë në ditë, e sipas mundësive një herë gjatë turnit nga ana e personit përgjegjës.

(2) Transporti bëhet me ndihmën e kontejnerëve me rrota ose karroca të cilat nuk përdoren për qëllime të tjera dhe që janë të prodhuara nga materiale jo depërtuese, që ngarkohen dhe





shkarkohen lehtë, nuk kanë thepe të cilat mund t'i dëmtojnë paketimet dhe të cilat mund të pastrohen dhe të dezinfektohen lehtë.

(3) Të gjithë etiketat e paketimeve duhet të jenë të pandryshueshme dhe të padëmtueshme gjatë transportit.

(4) Mbeturinat mjekësore duhet të transportohen nëpër një rrugë sa më të shpejtë e sa më të shkurtër.

(5) Rrugët e mbledhjes dhe transportimit të mbeturinave duhet të jenë të planifikuara paraprakisht dhe të shënuara qartë se ato duhet të jenë të veçuara nga ambientet në të cilat realizohen aktivitetet e zakonshme shëndetësore (pacientë, ambiente për rroba të pastra, materiale sterile, etj.) nëse kjo gjë është e mundur, e në të kundërtën transporti duhet të kryhet në një periudhë kohore kur nuk zhvillohen ose kur këto aktivitete janë me intensitet minimal.

Neni 9

V. Paketimi dhe magazinimi i mbeturinave mjekësore

(1) Paketimi dhe shënimi primar i mbeturinave mjekësore bëhet në vendin e krijimit të tyre.

(2) Paketimi primar për mbeturina mjekësore duhet të jetë për një përdorim.

(3) Për transportim më të lehtë paketimi sekundar, varësisht nga lloji i mbeturinave duhet të bëhet në paketime të forta të cilat nuk mundësojnë rrjedhje.

(4) Shenjat dhe ngjyrat e paketimit sekundar duhet të përputhen me shenjat dhe ngjyrat e paketimit primar.

Neni 10

(1) Pika mbledhëse qendrore për mbeturina mjekësore duhet të jetë një ambient i ndarë, i shënuar, i rrethuar, i mbuluar, i mbyllur i cili do shërbejë vetëm për atë qëllim.

(2) Pika mbledhëse qendrore për mbeturina mjekësore duhet të ketë dysheme të palëshueshme dhe të fortë i cili mund të pastrohet dhe dezinfektohet lehtë, të ketë akses në furnizimin me ujë dhe personat përgjegjës të cilët manipulojnë me mbeturinat të kenë akses të lehtë, si dhe automjetet me të cilat bëhet mbledhja e mbeturinave dhe të ketë mbrojtje nga dielli.





(3) Në pikën mbledhëse qendrore për mbeturina mjekësore nuk duhet të lejohet futja e kafshëve, insekteve dhe zogjve, duhet të jetë e ndriçuar dhe të ketë një ventilim minimal pasiv.

(4) Pika mbledhëse qendrore për mbeturina mjekësore nuk duhet të ndodhet në afërsi të ambienteve për ruajtjen e ushqimeve të freskëta ose në afërsi të ambienteve për përgatitjen e ushqimit.

(5) Pajisjet për pastrin, veshjet mbrojtëse dhe qeset si dhe kontejnerët për mbeturina duhet të jenë të vendosur në afërsi.

(6) Dezinfectimi i mjeteve ndihmëse të transportit bëhet një herë në ditë, ndërsa i pikës mbledhëse qendrore së oaku një herë në javë, e në rast nevojë edhe më shpesh.

Neni 11

Personat përgjegjës të cilët manipulojnë me mbeturinat duhet të jenë të trajnuar për manipulimin me mbeturinat mjekësore dhe të jenë të pajisur me veshje pune dhe dorashka mbrojtëse në përputhje me rregullat për mbrojtje gjatë punës.

Neni 12

VI. Transporti i jashtëm

(1) Transporti i mbeturinave mjekësore bëhet nga vendi në të cilin ato mbeturina janë të magazinuara dhe në afat kohor të caktuar në kontratën për mbledhjen dhe transportimin e mbeturinave të rrezikshme të lidhur me një person juridik ose fizik të autorizuar, por më së paku në çdo dy ditë.

(2) Gjatë përcaktimit të afatit kohor në kontratën nga paragrafi 1 i këtij Neni duhet t'i kushtohet kujdes aspektit të parandalimit të paraqitjes dhe zhvillimit të larvave të mizave.

Neni 13

Çdo kontigjent i mbeturinave, varësisht nga lloji dhe sasia e mbeturinave shoqërohet me një dokumentacion përkatës në përputhje me Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e ditarit për evidentimin e manipulimit me mbeturinat dhe formën dhe përmbajtjen e formularëve për raporte vjetore për manipulimin me mbeturinat.





Neni 14

VII. Përpunimi dhe mënjanimi

Mbeturinat infektive mënjahen në instalacione për djegjen e mbeturinave, ose me veprime për trajtim (copëtim, bluarje, dezinfektim, sterilizim) që të mund të sillen deri në atë formë e cila nuk do paraqesë rrezik për shëndetin e njerëzve dhe ambientin jetësor, e pas së cilës do mund të riciklohen ose mënjahen si mbeturina komunale.

Neni 15

(1) Mbeturinat patologjike mënjahen në instalacione për djegjen e mbeturinave të rrezikshme ose groposen në pjesë të veçanta të varrezave.

(2) Gjaku dhe tajtjet të cilat mbeten gjatë analizave laboratorike trajtohen si mbeturina infektive bashkë me vakujtanerët dhe epruvetat.

(3) Me gjakun dhe derivatet e gjakut të cilat gjatë analizave diagnostifikuese janë përzier me kimikalie, manipulohet si edhe me mbeturinat me kimikalie.

Neni 16

Mbeturinat kimike mënjahen në instalacione për djegjen e mbeturinave të rrezikshme dhe/ose deponohen në deponi për mbeturina të rrezikshme.

Neni 17

(1) Mbeturinat farmaceutike mënjahen në instalacione për djegjen e mbeturinave të rrezikshme.

(2) Barnat citotoksike dhe citostatikët me afat të skaduar, ose barnat të cilat nuk janë përdorur për qëllime terapeutike mënjahen trajtime përkatëse (inertizim dhe inkapsulim)

Neni 18

(1) Mbeturinat nga enët me presion mënjahen si mbeturinat komunale.

(2) Mbeturinat nga enët me presion nuk duhet të ndikohen nga temperatura të larta ppër shkak të rrezikut nga eksplozimi, dhe as të mënjahen pa u deaktivizuar.

(3) Enët me presion pas deaktivizimit të tyre mund të riciklohen.

Neni 19

Mbeturinat komunale pas selekcionimit të komponentëve të cilët mund të ripërdoren ose riciklohen mënjahen në deponi për mbeturina komunale.





VIII. Dispozita përmbyllëse

Neni 20

Kjo rregullore hyn në fuqi një ditë pas publikimit të saj në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndërsa do të zbatohet nga 01.01.2008.

Nr. 07-6239

31 tetor 2007

Shkup

Ministri i shëndetësisë

Dr. Imer Selmani,

Ministri i ambientit jetësor
dhe planifikimit hapsinor

Xhelil Bajrami,

Ministri i bujqësisë, pyjeve dhe administrimit të ujërave
Aco Spasenovski





SHTOJCË

Shenjë për mbeturina të rrezikshme infektive



Dangerous medical waste



